

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXVI - Nr. 7828 E premte 22 Mars 2019 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion *i* **Ditës**

Arti shqiptar, në kuptimin e mirëfilltë, por edhe figurativ, nuk mund të përbënte përjashtim nga gjendja e përgjithshme e kësaj "shoqërie shqiptare", që po ...
Vijon në faqen 20

Nga NAZIF ÇELA

Përcudnimi i artit, si "performancë"...



Opinion *i* **Ditës**

Edhe pse nuk ka kurrfarë ngjashmërie me vitin 1997, vendit po i fanepset një vit tjetër i mbrapshtë. Të mbërthyer pas magnetit të deklaratave të një politike ...
Vijon në faqen 21

Nga FATOS ÇOÇOLI

Fatura e pranverës së protestave



Shkodër/ Shoku i Nand Polias rrëfen krimin

Dëshmia për vrasjen e biznesmenit: U ula dhe dëgjoja vetëm zhurmën e plumbave

Hetimi: Ekzekutim profesionist, 20 gëzhoja në vendngjarje. Kolegët: Nuk shfaqte shqetësime

Një motoçikletë TMAX ngjyrë gri, erdhi përballë dhe drejtuesi me skafandër të zezë qëlloi në drejtimin tonë. Jam ulur dhe dëgjoja vetëm zhurmën e plumbave që shpoinin trupin e Nardit". Kështu ka deklaruar në polici pronari i servisit të makinave, Xhovan Mirashi, i cili i mbijetoi atentatit ku mbeti i vranë 35-vjeçari Ferdinand Polia. Mësohet se Mirashi ...
Në faqen 6

KRYEMINISTRI NUK MERR PJESE NE SEANCEN PLENARE, PERPLASJE JASHTE SALLES

OPOZITA RRETHON KUVENDIN, MUNGON RAMA: S'JAM SEMURË

Betohen 3 deputetët e rinj, sulmohet me bojë Ralf Gjoni. Basha takon kreun e PPE, Josef Daul. Rama: Opozita u katandis në tufë qorre, sajon sëmundje për kundërshtarin



(Në foto) Protesta e djeshme e opozitës. Kryetari i PD-së, Lulzim Basha me presidentin e PPE, Joseph Daul. Kryeministri Edi Rama
Në faqet 2-4

DRAFTI NE MINISTRI
Projektligji i ri i Shëndetësisë: Ndalohe shitja e paketave me 10 cigare
Në faqen 5

KRYETARI I PD
U thirr në prokurori, Basha u çon letër: Shkelje ligji dhe propagandë politike
Në faqen 7

KRYETARJA E LSI
Kryemadhi, kritika ambasadorit të OSBE: Na shih si parajsë seksi dhe parash
Në faqen 2

TRANSFERIMI I DOSJES
Marrëveshja e re lehtëson procedurën, tërheqja e pensionit tashmë në çdo sportel
Në faqen 8

UNIVERSITETI



Reforma në drejtësi dhe integrimi në BE, studentët gjermanë vizitë te "Luarasi"
Në faqen 9

Vendimi i qeverisë, familjet që fitojnë të drejtën mbi truallin e ndërtimit

Lista e dytë, 600 pronarët që marrin tapitë

Emrat/ Përfituesit në Tiranë, Durrës, Elbasan, Shkodër dhe Korçë

Miratohet lista me personat që kanë ndërtuar pa leje dhe fitojnë të drejtën e pronësisë mbi sipërfaqet ndërtimore. Me një vendim të veçantë, qeveria ka përcaktuar metra katrorë për parcelat ndërtimore në Tiranë, Shkodër, Durrës, Elbasan



dhe Korçë. Janë 600 përfitues në të gjithë vendin, të cilët do të marrin tapitë për truallin mbi të cilin kanë ndërtuar. Në listën e miratuar nga qeveria janë përcaktuar sipërfaqet për çdo përfitues, ndërsa ngarkohet ALUIZINI për pasqyrimin e tyre ...
Në faqet 10-11

PROTESTA OPOZITA

Pas 5 orësh protestë në shesh, Paloka: Nuk do të ketë asnjë ditë stabilitet

Basha në Bruksel: PPE na mbështet, s'bejmë kompromise

"Qytetarët kundër Maduros së Ballkanit"

Valentina Madani

Kryetari i PD-së, Lulzim Basha, në kthim nga Brukseli konfirmoi dje se ka marrë mbështetjen e PPE-së (Partive Popullore Europiane) për aksionin opozitar që po zhvillon në Shqipëri. Lideri i PD-së e shih si mbështetje mesazhin e Joseph Daul për demokracinë dhe shtetin ligjor. "Presidenti i PPE, Joseph Daul, në emër të të gjithëve deklaroi qartë se 'ne nuk mund të bëjmë kompromise me demokracinë, shtetin ligjor dhe lirinë e medias'. PD po lufton për të njëjtat vlera europiane në Shqipëri dhe në këtë betejë kemi mbështetjen e PPE, familjes sonë politike", shkruan Basha. Teksa kreu demokrat zhvilloi protestën e gjashtë para parlamentit kundër qeverisë "Rama". Më herët, përmes një tjetër statusi në rrjetin social "Facebook", Basha theksoi se qytetarët janë ngritur në protestë kundër Maduros së Ballkanit. Basha shprehet se sovranë në Republikën e Shqipërisë është populli shqiptar. "Drejt Drejtorisë së Policisë për të liru qytetarët, që janë ngritur kundër Maduros së Ballkanit! Sovrani në Republikën e Shqipërisë është populli shqiptar. Shqipëria si Europa", shkruan Basha. Pavarësisht mungesës së kryetarit të PD-së, u protestua dje për 5 orë para Kuvendit dhe Drejtorisë së Policisë. Nën kryetari i PD-së, Edi Paloka, mbylli protestën e opozitës. Në mungesë të kreut të PD-së, Paloka ndau edhe mesazhin e tij nga Brukseli. Ai u shpreh se në mungesë, kreu demokrat u dërgon një përsëritje të protestuesve, ndërsa vazhdon takimet në Bruksel si pjesë e fitores së ardhshme. "Edhe njëherë doja t'ju përsëritës dhe t'ju falënderoj për sot për të arritur nesër në fitoren e sigurt. Dua t'ju përsëritës



Kryetari i PD-së, Lulzim Basha, gjatë takimit të djeshëm me presidentin e PPE, Joseph Daul

MBËSHTETJA
"Presidenti i PPE, Joseph Daul, në emër të të gjithëve deklaroi qartë se, 'ne nuk mund të bëjmë kompromise me demokracinë, shtetin ligjor dhe lirinë e medias'. PD po lufton për të njëjtat vlera europiane në Shqipëri dhe në këtë betejë kemi mbështetjen e PPE, familjes sonë politike", - shprehet z.Basha.

Shehaj: Fyeve taksapaguesit shqiptarë

Sulmohet me bojë, Gjoni: S'kam ardhur për një rrogë të qelbur

Deputeti më i ri i LSI që ka pranuar të marrë mandatin, Ralf Gjoni, u sulmua mëngjesin e djeshëm përpara banesës së tij, ku një protestues i hodhi bojë në fytyrë. Gjoni u shpreh për mediat se sulmi ndaj tij me bojë ishte i porositur nga lart. Sipas Gjoni, qëllimi i tij është të përfaqësojë qytetarët që e kanë votuar dhe për këtë arsye ka pranuar mandatin e deputetit. "Më hodhën bojë me anë të një shiringe. Ai dhe ajo që e kanë porositur këtë lloj sjelljeje rrugësh duhet ta dinë që kam ardhur këtu të betohem dhe nuk frikësohem në asnjë moment. Jam këtu që të përfaqësoj të gjithë ata të rinj dhe të reja që kanë shpresë se ky vend mund të bëhet. Unë kam ardhur për t'u betuar, nuk kam ardhur



për të marrë një rrogë të qelbur shteti, por të përfaqësoj ata shqiptarë që ndihen të papërfaqësuar. Nuk do të lejoj kurrë që emri im të keqpërdoret. Mendoni që unë vij për t'i bërë fresk qeverisë", shprehet Gjoni, i cili më pas u betua si deputet në parlament. Por, ish-drejtoresha e Tatimeve, Brisida Shehaj, kritikoi ashpër deputetin

e ri që përfaqëson LSI pas deklarimit se nuk u fut në parlament për atë "rrogë të qelbur". Shehaj shprehet se nëse ai do e kishte bërë këtë deklaratë në ndonjë vend tjetër, do e kishin nxjerrë "me shpulla jashtë parlamentit". "Në daljen e parë si deputet, ky individ i fyen taksat tona duke thanë se 1.6 mln lekë neto na qenkan të qelbura në Shqipëri. Ky individ që i kushtoi LSI-së rezultatin më të dobët në Tiranë (njësia 3). Ky individ që na qenka me dy pasaporta dhe i shkolluar jashtë, ta kishte bërë këtë deklaratë andej, e kishin nxjerrë me shpulla jashtë parlamentit. (Gjithsesi dhe këtë s'e ka problem, ky se e ka të provuar). Mjerë taksat tona që i hanë deputetë parazitë", tha zj.Shehaj.

për të drejtat e tyre. Nuk ka asnjë forcë që na ndal. Nuk do ketë asnjë ditë stabilitet për këtë qeveri derisa të kthehet demokracia. Sukses dhe fitore!", - u shpreh Paloka. Nën kryetari demokrat nga selia e PD-së pas 5 orëve të

protestës akuzoi kryeministrin Edi Rama për arrogancë, ndaj e paralajmëroi se fundi i tij po afrohet. "Ai zotëria që vazhdon të qëndroj me arrogancë në karrigen e kryeministrit, edhe pse e di shumë mirë se shqiptarët nuk e



Protesta e djeshme e opozitës

"Për Borchardt, Shqipëria si parajsë seksi dhe paraje"

Kryemadhi: Presidenti të bëjë detyrën, si bashkëshorte s'merrem me politikë

Kryetarja e LSI-së, Monika Kryemadhi, u distancoi nga qëndrimet e Presidentit Ilir Meta se është gati të dorëzojë mandatin për zgjidhjen e krizës në vend. "Si bashkëshortja e tij, nuk merrem fare me punën politike, si kryetare e LSI-së, LSI ka pozicionin e saj shumë të qartë në marrëdhënie me parlamentin, me qeverinë, me reformën në drejtësi, e cila ka dështuar, sepse sot shqiptarët janë në rrugë për shkak të mungesës së Gjykatës Kushtetuese, sepse ligji për dividentin që presidenti e ktheu, këta përsëri manipuluan në mënyrë me kriminale dhe korruptive në Komisionin e Ekonomisë dhe e rikthyen ligjin edhe një herë në fuqi, sepse krijonte varfërinë e shqiptarëve. Çfarë do të thotë kjo? Do të thotë që iu vodhën buxhetit të shtetit me qindra milionë euro, kur ndërkohë fukarenjtë kishin paguar edhe taksat e tjera e me radhë dhe çfarë do të thotë kjo? Kjo do të thotë që ky parlament nuk ka më mundësinë për çdo padrejtësi që i bëhet opozitës, apo kujt do deputeti tjetër nuk i është dhënë më mundësia për të vazhduar për të shkuar në Gjykatë Kushtetuese, kështu që automatikisht këtu ka rënë shteti. Se ç'do të bëjë presidenti, është zgjedhja e tij dhe dhe qëndrimi i LSI-së nuk ka të bëjë as me qëndrimet e presidentit, ne këtu jemi në qëndrim të unifikuar të opozitës, ku të gjitha partitë opozitare janë dakord. Këtu nuk është më vetëm opozita, këtu janë edhe të gjithë shqiptarët. Presidenti le të bëjë punën e tij, ajo është puna e tij zyrtare, legjitime, jolegjitime nuk kam asnjë arsye për ta komentuar. Unë jam këtu për të komentuar pozicionin e LSI dhe më shumë si qytetare sesa si kryetare", deklaroi zj.Kryemadhi. Ajo refuzoi të komentojë deklaratat e ambasadorit të OSBE në Shqipëri, Bernard Borchardt për krizën politike. "Unë nuk përgjigjem për njerëz që e shikojnë Shqipërinë si parajsë të seksit dhe parajsë", tha zj.Kryemadhi.



duan më, nuk duan ta shohin më me sy, duhet ta kuptojë një orë e më parë se ka zgjedhur rrugën më të gabuar. Nuk mund t'i mbash shqiptarët të rrethuar me tela me gjemba, nuk mund ta mbash karrigen, duke u re-

thuar me forca speciale, nuk mund ta mbash pushtetin e të bredhësh nëpër Shqipëri me antiplumb. Fundi yri ka ardhur, je vetëm një kufomë, një kufomë që zvarritet si zombi nëpër Shqipëri", theksoi nënkryetari i PD-së.



Valentina Madani

Opozitarët u mbledhën dje para Kuvendit në të shumtë në numër dhe shumë herë më të vendosur për të larguar Kryeministrin Edi Rama. Përgjatë 5 orëve ata protestuan para godinës së Kuvendit dhe Drejtorisë së policisë për protestuesit e shoqëruar. Në krye të protestës nuk ishte lideri i PD-së Lulzim Basha, i cili ndodhet në Bruksel, në kongresin e Partive Popullore Europiane. Protestën e udhëhoqi kryetarja e LSI-së Monika Kryemadhi, dhe demokratët Gazmend Bardhi, Edi Paloka, Flamur Noka dhe Ervin Salianji. Ish-Kryeministri Sali Berisha mbërriti disa minuta pas nisjes së protestës dhe u prit menjëherë me ovacione të mëdha dhe me thirrje në kor "Berisha, Berisha". Policia nuk përdori në asnjë moment gaz lotsjellës, por forcoi kordonet policor që protestuesit të mos përparonin drejt Kuvendit. Disa herë pati momente dhe tensionin ku protestuesit u përpoqën të çinin kordonin dhe drejt efektiveve goditën me tymuese dhe kopsolla. Përgjatë 5 orëve të demonstrimit, protestuesit disa herë tentuan thyerjen e kordonit të policisë. Policia këtë herë nuk përdori gazin lot sjellës. Në mes të vapës protestuesit shpërndanë ujë për policët ndërkohë që kërret e opozitës u ulën këmbëkryq para kordonit policor me skafandra. Përplasjet nuk munguan as këtë radhë. Edhe disa prej protestuesve janë parë të ulen para parlamentit. Ky veprim i tyre u lexua si një mesazh qëndresë, se ata do të ulen e do të rrinë gjatë aty, edhe kryetarja e LSI-së, Monika Kryemadhi dhe disa deputetë.

"Rama ik", mijëra protestues rrethuan parlamentin dhe tentuan çarjen e kordonit të policisë

Opozita 5 orë protestë para Kuvendit e Drejtorisë së Policisë

Gurë e tymuese, por edhe ujë për policët



Kryetarja e LSI-së, Monika Kryemadhi, dje me protestuesit para Kuvendit

MARSHIMI

"Shqiptarët e bashkuar, kanë për të fituar" - me këtë thirrje, banorët e Unazës së Re protestuan mbërrmë para Drejtorisë së Policisë së Tiranës. Ashtu sikurse edhe në protestat e mëparshme, ata mbështeten nga përfaqësuesit e opozitës. Ata kërkuan lirin Dorian Protoduarit dhe disa protestuesve të tjerë. Banorët e Unazës së Re protestojnë prej 138 ditësh.

KONTROLLET

Në përfundim të protestës së opozitës, policia dje shoqëroi në Drejtorinë e Policisë së Tiranës dy banorë të 'Astirit' që morën pjesë në tubimin para parlamentit. Në polici dje u shoqërua Dorian Prodouari, banori i Unazës së Re, i cili është organizatori i protestuesve. Ka dhe disa të tjerë të shoqëruar, por zyrtarisht nuk dihet numri i saktë. Policia ushtroi kontrolle dhe në banesat e zonës së 'Astirit'.



Protestuesit rrethojnë policinë, Lleshaj: Protesta, e verbër

Ministri i Brendshëm Sandër Lleshaj përmes një postimi në Twitter ftoi dje qytetarët të mbështesin policinë ndërsa e quajti protestën të verbër. Lleshaj, tha se protestat e verbra që godasin deputetë, institucione dhe policë, pengojnë shumë policë që të merren me detyrën e tyre kryesore, që është lufta kundër krimit. Ai i ftoi qytetarët që të mbështesin Policinë e Shtetit në luftën e përbashkët kundër krimit për një Shqipëri normale, ndërsa shprehu mirënjohje për dinjitetin dhe përkushtimin e punonjësve të policisë. "Protestat e verbra që godasin deputetë, institucione dhe policë, sjellin vetëm një rezultat. Ato pengojnë shumë policë që të merren me detyrën e tyre kryesore, që është lufta kundër krimit. Ftoj qytetarët që të mbështesin Policinë e Shtetit në luftën e përbashkët kundër krimit për një Shqipëri normale, ndërsa shprehu mirënjohje për dinjitetin dhe përkushtimin e punonjësve të PSH" -shprehet ministri i Brendshëm. Z.Lleshaj reagoi pas momentit të rrethimit të Drejtorisë së Policisë së Tiranës nga protestuesit e opozitës.



DEKLARATA

"Parlamenti është njëngjyrësh dhe spërkatja me bojë e Ralf Gjonit është pjesë e spektaklit. I pëlqen qeverisë që të quajë si opozitë të re deputetët që kanë marrë mandatin, por ajo nuk është opozitë. Mua si qytetar i këtij vendi më preokupon se çfarë bën opozita jashtë", tha z.Besnik Mustafaj.



DENONCIMI

"Përsëri mbi atë institucion shumë të nderuar kultu i panë 'Hije të errëta', të cilat si 'skutha' dhe në shkelje të rëndë të paprekshmërisë të të tilla institucioneve, të fshehur mbas minares, operonin prej aty me instrumente speciale drejt protestuesve", tha z.Tritan Shehu.

shashkat e hedhura në drejtim të tyre prej protestuesve, të cilët mbanin flamuj kombëtar në duar, si dhe përdorën vuvuzela. Policia e Shtetit u drejtua me një thirrje organizatorit të protestës së PD-së, Gazmend Bardhi. Poli-

PD zbulon policët e infiltruar në protestë: Pa mjet identifikues, me kodin e familjes mafioze

Kreu i Forumit Rinor të Partisë Demokratike, Belind Këlliçi publikoi dje pas protestës së madhe të opozitës disa fotografi të atyre që ai i quan policë civilë të infiltruar në protestë. Teksa shprehet se ishin pa mjet identifikimi, Këlliçi shkruan se policët vepruan me kodin e familjes mafioze. "Këta janë civilët e bandës së Edi Ramës që përndjekin të rinjtë dhe qytetarët që protestojnë. Pa asnjë shenjë identifikuese, por me kodin e familjes mafioze të rilindjes dhunojnë, ndalojnë dhe çojnë nëpër komisarate a bodrume bashkish të



rinjtë që janë kundër padri-nos. Po të kishte prokurori të pa kapur, sot kapobanda dhe tufa e banditëve të tij do ishin para drejtësisë. Por meqenëse prokuroria është

bërë njësh me familjen mafioze të rilindjes, atëherë i lind e drejta qytetareve t'u japë atë që meritojnë banditëve", shkrehet kreu i FRPD-së.

cia bëri thirrje për qetësi dhe për largimin e protestuesve që mbajnë maska. "I nderuar Zoti Bardhi, në mes të protestuesve ka persona që mbajnë maska. Si organizator i tubimit në bazë të ligjit për tubimet merrni masa për largimin e tyre nga tubimi". Por protestuesit kërkuan largimin e kryeministrit Edi Rama dhe zgjedhje të parakohshme.

SOLIDARIZIMI

Më pas protesta u spostua drejt Drejtorisë së Policisë së Tiranës, aty ku opozita, deklaroi se mbahen të shoqëruar disa protestues. Protesta u zhvillua jashtë godinës së parlamentit për tre orë e 30 minuta, por protestuesit qëndruan aty për afro 90 minuta në shenjë solidarizimi me protestuesit e

shoqëruar nga policia. Tensionet pati edhe Drejtoria e Policisë së Tiranës. Pak pas zhvendosjes pranë ambienteve të Drejtorisë së Policisë së Tiranës, protestuesit kërkuan jo vetëm lirin të protestuesve të tjerë, por agratuan situatën duke qëlluar me shishe xhamat e Drejtorisë së Policisë tekta pati edhe thyerje xhamash. Në gatishmëri para godinës u panë një numër i madh policësh, por edhe FNSH-të. Brenda godinës ishin shoqëruar disa protestues, prandaj edhe protestuesit u zhvendosën para drejtorisë së policisë. Kërret e opozitës Kryemadhi, Bardhi dhe Noka u futën brenda ambienteve të drejtorisë dhe pas 30 minutash, përfaqësuesit e PD dhe LSI dolën nga ambientet e

Drejtorisë së Policisë së Tiranës. Kryetarja e LSI-së Monika Kryemadhi tha se kishin një ultimatum të qartë për policinë, që të lironin protestuesit, në të kundërt askush nuk do largohet. Pasi u siguruan që protestuesit do liroheshin, Monika Kryemadhi, nënkryetari i PD-së Edi Paloka dhe mbështetësit marshuan drejt selisë së PD-së për të njoftuar mbylljen e protestës, jo betejën. "Beteja jonë nuk ka mbaruar. Jemi nisur në një rrugë që nuk ka tjetër veç fitores. Nuk ka forcë që na ndal në rrugën tonë prej një demokraci në Shqipëri. Jam i bindur që kësaj rruge do i shkojmë deri në fund. Rama ik!" u shpreh Edi Paloka. Protesta e nisur në orën 10:00 u mbyll në orën 15:00 pa incidente.

**KUVENDI
NUMRAT**

Murrizi: Ka 3 palë zgjedhje që i fshihemi votës së popullit

Për herë të parë që nga përfundimi nga Partia Demokratike, Myslim Murrizi ka marrë dje pjesë në seancën plenare, ku mbajti edhe një fjalim që ia kushtoi protestës së opozitës dhe nevojës për të ndryshuar sistemin zgjedhor. Sipas tij, situata në të cilën gjendet sot Shqipëria është produkt i faktit se deputetët nuk janë të lirë dhe nuk kanë pavarësi, pasi i tremben frikës se mos kryetari i partisë nuk i kandidon, ose i vendos në pozicione jo fituese në listat shumëëmërore të kandidatëve. "Në 22 marsin e 27 viteve më parë, shqiptarët hoqën Partinë e Punës së Shqipërisë, por



nuk i hoqën dot komunistët. Ata kanë qeverisur vendin në këto 27 vjet, pavarësisht se herë ndërrojnë xhaketat dhe herë kalojnë ylberin. Jemi në një sistem politik të

kapur prej ftyti për t'iu shmangur ballafaqimit direkt. Sot duhet prishur sistemi politik. Kemi tri palë zgjedhje që i fshihemi votës së këtij populli", - tha Murrizi. Ndërsa komentoj protestën e opozitës, ai theksoi se ishte me protestuesit, por jo me drejtuesit e partisë. "Për mua duhet të prishet sistemi politik. Atje flasin në emër të popullit, këtu thonë se flasin në emër të popullit, po asgjë nuk bëhet. Ka 3 palë zgjedhje që i fshihemi votës së këtij populli. Mos ndërroni qarqet dhe trastat. I mashtroni këto 4 vite në një qarq dhe shkoni

në qarq tjetër dhe i mashtroni edhe ata. Ju që jeni sot në maxhorancë, ai ju ka vënë në rresht për të pranuar ministra që nuk kanë qenë në këtë sallë, sepse ju tremb me emrin në listë, je i treti të çoj i 13-ti dhe vijnë këtu njerëz që s'kanë asnjë përgjegjësi politike. Një vit e gjysmë kam kërkuar nga kryetari ç'bënte me reformën zgjedhore, por belbëzonte në tavolinë, sepse ka hall se nuk dalin deputetë në shprehje servilësh, që jargavitën si kërmij para paradhomës së kryetarëve të partisë", - tha ndër të tjera Murrizi.



Seanca e djeshme parlamentare

Ralf Gjoni, Enada Koçiraj dhe Nimet Musaj, të tre nga LSI-ja janë betuar si deputetë

Kuvendi shkon në 96 deputetë, opozitën e "tradhtojnë" edhe 3 të tjerë

Alimadhi, kreu i Ballit Kombëtar, do të marrë mandatin

Janë betuar dje 3 deputetë e rinj të Kuvendit të Shqipërisë, të cilët morën mandatin e lëna nga deputetët e opozitës. Ralf Gjoni, Enada Koçiraj dhe Nimet Musaj janë tre deputetët më të rinj të Kuvendit, të cilët vijnë nga radhët e lëvizjes Socialiste për Integrim. Kështu, së bashku me ta Kuvendi mbërrin në 96 deputetë të pranishëm, prej të cilëve 17 opozitarë dhe 79 të mazhorancës. Por, ky numër pritet të shkojë në 99 javën tjetër, teksa pritet që të marrin mandatin edhe 3 kandidatë të tjerë, dy që vijnë nga listat e PD dhe një nga listat e LSI-së. Më konkretisht bëhet fjalë për Arben Elezi nga listat e PD të qarqut Elbasan, Adriatik Alimadhi kreu i Ballit Kombëtar që vjen nga listat e PD-së në qarqun Vlorë dhe Amra Borova nga listat e LSI-së të qarqut Shkodër. Të tre këta kandidatë kanë dorëzuar në KQZ formularin e vetëdeklarimit të dekriminalizimit, çka përbën edhe hapin drejt marrjes së mandatit të deputetit. Pasi KQZ të bëjë verifikimin normal të dokumentacionit të tyre, pritet që para se të mbahet seanca e radhës e Kuvendit të Shqipërisë, të



bëhet edhe kalimi i mandatit për tre deputetët e rinj. Natyrisht që shifra totale e

- DEPUTETËT E OPOZITËS SË RE**
- Eida Hoti - LSI
 - Edriola Braha - LSI
 - Edlira Hyseni - LSI
 - Lefter Maligji - PD
 - Majlinda Halilaj - PD
 - Alban Zeneli - PD
 - Ligoraq Karamelo - PD
 - Ylli Shehu - LSI
 - Enver Roshi - LSI
 - Edmond Rrushaj - LSI
 - Aurora Mara - LSI
 - Ralf Gjoni - LSI
 - Nimet Musaj - LSI
 - Enada Koçiraj - LSI
 - Rudina Hajdari - PD
 - Myslim Murrizi - PD
 - Lefter Koka - LSI

deputetëve në Kuvend pritet të rritet edhe më tej, pasi edhe të tjerë kandidatë kanë deklaruar se do marrin mandatin. Por, pavarësisht se deputetët e rinj vijnë nga listat e partisë opozitare dhe në Kuvend kanë zënë karriqet e opozitës, ata duket se kanë vendosur që të jenë vazhdimësi e mazhorancës aktuale. Kjo është vënë re edhe nga qëndrimi që ata kanë mbajtur me votë në Kuvendin e Shqipërisë gjatë këtyre javëve, ashtu si edhe gjatë votimit të djeshëm. Kështu, të gjitha ligjet e miratuara dje nga Kuvendi kanë marrë 82 vota, një shumicë kjo që shkon përtej mazhorancës aktuale, që ka

79 deputetë në gjirin e saj. Kështu, rezultoni që 3 nga deputetët e opozitës së re të kenë votuar por nismave ligjore të qeverisë. Jo vetëm kaq, por as pjesa tjetër e opozitës së re nuk votoi kundër këtyre. "Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunimin financiar 2016 për projektin "Programi i investimeve për shpërndarjen e energjisë elektrike I" u miratua me 82 vota pro dhe asnjë kundër. Po ashtu edhe ligji "Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunimin teknik 2017 për projektin "Zhvillim i qëndrueshëm i zonave rurale", mori po ashtu 82 vota pro dhe asnjë kundër apo abstenim. Edhe vendimi "Për një ndryshim në vendimin "Për caktimin e anëtarëve zëvendësues në komisionet e përhershme" u miratua me 82 vota pro dhe asnjë kundër. I vetmi vendim që mori vota kundër ishte ai për miratimin e raportit të ERRU.

SHKURTE

Rama: Pika që s'ju bie, opozitë e katandisur në një tufë qorre

Kryeministri Edi Rama ka hedhur poshtë si të pavërteta lajmet që kanë qarkulluar ditët e fundit se ai ka shkuar për mjekim jashtë vendit. Nëpërmjet një statusi në rrjetet sociale, Rama ka reaguar ashpër duke theksuar se arsyeja e largimit të tij jashtë shtetit nuk kishte të bënte me shëndetin e tij, por me përpjekjen për të përmirësuar imazhin e Shqipërisë nga protestat e opozitës. Ai u shpreh se opozita bën politikë duke sajuar kriza për vendin dhe sëmundje për kundërshtarin politik. "Po boll o boll, boll se s'kam asgjë tjetër përveç larjes së jashtëm që tuaja nëpër botë, boll! Opozitë e katandisur në një tufë qorre, që mësyn fizikisht rrugëve dhe bën politikë duke sajuar kriza për vendin e sëmundje për kundërshtarin! O pika që s'ju bie kur thonë plakat", - shkruan Rama.

Rudina Hajdari: Dua të sjell një frymë të re parlamentare

Ashtu si Myslim Murrizi, edhe Rudina Hajdari ka marrë pjesë në seancën plenare për herë të parë që nga momenti që vendosi të mos i bindej vendimit të partisë për të djegur mandatin. Në një fjalë të shkurtër në Kuvend, ajo u shpreh se ishte në politikë për të bërë hapa të sigurt larg politikës së vjetër, ndërsa theksoi se askush nuk mund ta gjykonte për vendimet e marra. "Askush nuk mund ta gjykonte vendimin tim, do bëj hapa të sigurt larg politikës së vjetër. Në ditët dhe muajt që do vijnë do të kem propozime konkrete për ta kthyer vendin në normalitet. Unë dua të sjell një frymë të re parlamentare, që do t'i japë fund njëherë e përgjithmonë këtij tranzicioni", - tha ajo. Hajdari theksoi se ky sistem politik duhet të marrë fund, pasi nuk mendon aspak për qytetarët. "Politika nuk është vetëm model i keq-qeverisjes. Ky model që nuk do t'ia dijë për largimin masiv të qytetarëve, për jetën duhet të marrë fund. Nuk është hera e parë që paqëndrueshmëria politike rrezikon stabilitetin e vendit, apo marrëveshjet e fshehta prapa shpinës së popullit. Unë u rrita me thirrjen "E dua Shqipërinë si gjithë Europa", - u shpreh Hajdari.

Njoftim shitje me ankand

Shoqëria përmbarimore "AA Bailiff" shpk, zhvillon ankandin e II-të, për shitjen e pasurisë së paluajtshme, Trull 310 m2 dhe ndërtesë 96 m2, me nr. pasurie 170/14, Vol. 8, Fq. 154, ZK. 3852, në pronësi të Ruzhdi Demir Tropinji e regjistruar në ZVRPP Durrës. Cmimi i ankandit të dytë është EUR 24.000 (njëzet e katër mijë euro).

Ankandi zhvillohet dt. 08/04/2019, ora 16.00 në adresën Rruga e Kavajës, Ndërtesa 27, Hyrja 1, Kati i III-të, Tiranë.



"Gazeta Shqiptare" zbardh projektligjin e Ministrisë së Shëndetësisë kundër duhanit

Ashpërsohen rregullat për duhanin, stejohen paketat me 10 cigare

Nuk lejohet pirja e cigares elektronike në ambiente të mbyllura

Kohë akoma më të vështira pritet të vijnë për duhanpirësit. Kjo, pasi qeveria ka ndërmarrë disa ndryshime të tjera ligjore, që synojnë të forcojnë edhe më shumë regjimin kundër duhanit, çka sipas saj do të sjellë një reduktim të numrit të duhanpirësve edhe me 5 përqind të tjera. "Gazeta Shqiptare" zbardh nismën ligjore të Ministrisë së Shëndetësisë, me anë të së cilës propozohen disa amendamente në ligjin "Për mbrojtjen e duhanit" dhe që të plotësojnë kuadrin rregulator për produktet e reja të duhanit që kanë hyrë në treg vitet e fundit si dhe ndalimin e promociionit indirekt të produkteve të duhanit. Kështu, më konkretisht një nga risitë që sjell ky projektligj është ai për ndalimin e shitjes së paketave me numër të reduktuar cigaresh, apo me alterim të shijeve. Ndryshimi konstaton në detyrimin e importuesve dhe shitësve të duhanit me pakicë që të mos shesin paketa me më pak se 20 cigare. "Ndalohet vendosja në treg e produkteve të duhanit me shije jokarakteristike. Një njësi pakete cigare duhet të përmbajë të paktën 20 cigare. Një njësi pakete duhan për dredhje duhet të përmbajë jo më pak se 30 gramë neto produkt duhani", - propozohet në projektligj. Sipas relacionit të ministrisë, ky detyrim pritet të reduktojë blerjen e këtyre



sipas kësaj dispozite, dyqanet apo marketet do ta kenë të ndaluar që ta reklamojnë më duhanin në vitrina apo raftet të ndryshme. Kjo bëhet në kuadër të forcimit të kontrollit për moslejimin e promociionit dhe marketimit të produkteve të duhanit si një faktor që stimulon përdorimin e tij në popullatë. Njëprmet këtij projektligji, Ministria e Shëndetësisë kërkon të ndalojë edhe përdorimin e cigares elektronike dhe duhanit me ngrohje në ambiente të mbyllura duke aplikuar për të, të njëjtat rregulla si për format konvencionale të duhanpirjes. Gjithashtu, njëprmet këtyre ndryshimeve synohet të forcohet kontrolli i duhanit dhe të shmangen rastet abuzive. Gjithashtu, bëhet detyrimi i prodhuesve dhe/ose importuesve të produkteve të duhanit për të informuar Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për hyrjen në treg të produkteve të reja, që të duhanit synon të mbajë të informuar organet përkatëse për dinamikën e hyrjes së produkteve të reja në treg. Projektligji parashikon edhe forcimin e masave ndëshkuese në rast moszbatimit të ligjit, çka ka për synim të forcojë implementimin e ligjit dhe shtimin e mbrojtjes për qytetarët që ekspozohen në mënyrë të pavarur ndaj timit të duhanit, qoftë nga produktet tradicionale, qoftë nga produkte inovative.

PROJEKTIGJI

- Çdo njësi paketime e cigareve elektronike dhe paketime i rimbushjeve të lëngut të nikotinës duhet të përmbajë informacion mbi instrukcionet e përdorimit, kundëriindikacionet, paralajmërimet për efekte anësore, shkallën e varësisë dhe toksicitetin si dhe detajet e kontaktit të prodhuesit ose importuesit.
- Lëngu me përmbajtje nikotine vendoset në treg vetëm kur është në mbajtje të dedikuara për rimbushje me volum jo më shumë se 10 ml ose në formën e cigareve elektronike njëpërdorimshme me volum jo më shumë se 2 ml.
- Nuk lejohet vendosja në treg e lëngut që përmban më shumë se 20mg/ml nikotinë.
- Ndalohet vendosja në treg e produkteve të duhanit me shije jokarakteristike.
- Një njësi pakete cigare duhet të përmbajë të paktën 20 cigare. Një njësi pakete duhan për dredhje duhet të përmbajë jo më pak se 30 gramë neto produkt duhani.
- Ndalohet çdo lloj forme tjetër reklamimi i produkteve të duhanit, përfshirë promociionin indirekt përmes ngjyrave që përfaqësojnë logot e kompanive, ose promociionin nëpërmjet vendosjes së produkteve të duhanit në forma të caktuara.
- Për shkelje të nenit 15 dy herë brenda një periudhe 3-mujore, subjekti i tatueshëm dënohet me gjobë sa dyfishi i gjobës së vendosur në gërmën e/it të këtij neni.
- Nëse subjekti i tatueshëm i penalizuar për herë të dytë gjendet përsëri në shkelje nenit 15 brenda një afati kohor 1-vjeçar, atëherë ndaj tij vendoset gjobë në vlerën dyfishëfishi i gjobës së vendosur në gërmën e/it të këtij neni dhe pezullim të aktivitetit deri në shlyerjen e masave të gjobës.

REKLAMIMI

"Ndalohet çdo lloj forme tjetër reklamimi i produkteve të duhanit, përfshirë promociionin indirekt përmes ngjyrave që përfaqësojnë logot e kompanive, ose promociionin nëpërmjet vendosjes së produkteve të duhanit në forma të caktuara", - thuhet në këtë draft. Pra, sipas kësaj dispozite, dyqanet apo marketet do ta kenë të ndaluar që ta reklamojnë duhanin në vitrina apo raftet të ndryshme.

produkteve nga konsumatorë që nuk e përballojnë dot çmimin e një pakete të plotë apo nga konsumatorë për të cilët shija karakteristike e duhanit është një element i pakënaqshëm i duhanpirjes dhe në mungesë të shijeve alternative do zgjidhni në mos konsumimin produkton. Një tjetër risi e projektligjit është ndalimi i promociionit të indirekt nëpërmjet

ngjyrave të logos së produkteve të duhanit dhe vendosjen e tyre në raftet të dukshme. "Ndalohet çdo lloj forme tjetër reklamimi i produkteve të duhanit, përfshirë promociionin indirekt përmes ngjyrave që përfaqësojnë logot e kompanive, ose promociionin nëpërmjet vendosjes së produkteve të duhanit në forma të caktuara", - thuhet në këtë draft. Pra,



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BANKA E SHQIPERISE
DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT
SEKTORI I PROKURIMIT

TENDER I HAPUR KOMBËTAR

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: "Shërbimi vjetor i mirëmbajtjes dhe riparimit të ashensorëve në godinat e Bankës së Shqipërisë"

"Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me **fond limit 1,840,000 Lekë**".

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Halili", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411 (ext. 1844), çdo ditë nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraparakshisht pagesën e paktyeshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në logarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfutuesi: Banka e Shqipërisë
BIC: STANALTR
IBAN: AL68 1011 1008 0000 2222 222L; BIC

Përkshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: "Shërbimi vjetor i mirëmbajtjes dhe riparimit të ashensorëve në godinat e Bankës së Shqipërisë"

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më **datë 12 Prill 2019, ora 11:00**, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BANKA E SHQIPERISE
DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT
SEKTORI I PROKURIMIT

FTESE PER KUOTIM KOMBËTAR

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: "Shërbimi konsulence në fushën e redaktimit (**proofreading**) në gjuhën angleze për përcjelljen në publik të informacionit të BSH për vitin 2019"

Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Ftesë për kuotim kombëtar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me **fond limit 472,000 Lekë**".

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Halili", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411 (ext. 4251), çdo ditë nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim.

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më **datë 27 Mars 2019, ora 14:00**, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.

TIRANË - Shtyhet seanca gjyqësore për ish-ministrin e Brendshëm, Saimir Tahiri. Mesditën e djeshme ai mbërriti në Gjykatën për Krime të Rënda, ku do të zhvillohej seanca paraprake dhe do të merrej një vendim për dosjen. Së bashku me Tahirin, pjesë e dosjes në seancën paraprake, janë edhe tre ish-punonjësit e policisë, Jaël Çela, Gjergji Kohila dhe Sokol Bode. Avokati i tij, Maks Haxhia tha se seanca u shty, pasi nuk ishin njof-



Shtyhet seanca paraprake për ish-ministrin Saimir Tahiri, avokati: Kërkojmë pafajësi

tuar të pandehurit e tjerë, të cilët ndonjëse janë në kërkim, procedura e kërkon që të bëhet njoftimi. Ai bëri me dije se seanca e radhës u la më datë 26 mars, në ora 10:00. "Do të kërkojmë pafajësi dhe që të vlerësohen gjitha provat, me qëllimin final që Saimir Tahiri është shtetas i pafajshëm që

nuk mund të akuzohet për këto vepra. Nëse vazhdon kalvari i zvarritjeve do të bëjmë kërkesë për gjykim të shkurtuar, pasi nuk ka asnjë provë që të çojë para përgjegjësisë zotin Tahiri", u shpreh Haxhia. Gjykata për Krime të Rënda pritej të zhvillonte dje seancën paraprake gjyqësore, ku

Tahiri do të përballej me akuzat e prokurorisë, pasi e fundit kërkon marrjen e ish-ministrin si të pandehur. Ndaj ish-ministrin janë ngritur akuzat e veprave penale "Trafik ndërkombëtar droge" në bashkëpunim, "Grup i strukturuar kriminal" dhe "Shpërdorim detyre".

Mbyllja e hetimeve ndaj ish-ministrin dhe dërgimi i dosjes në gjykatë, u bë pasi më 11 shkurt Gjykata e Krimeve të Rënda, pranoi kërkesën e ish-ministrin të Brendshëm, për të mos zgjatur hetimet me tre muaj të tjerë. Saimir Tahiri është vënë nën hetim, si i dyshuar për lidhje me grupin "Habibaj" që merrej me trafik droge drejt Italisë. Ai akuzohet se i krijonte lehtësi grupit në aktivitetin kriminal.

Drejtori i AZM: E takova para atentatit, ishte i qeshur dhe me humor

SHKODËR

Njëmotoçikletë TMAX ngjyrë gri, erdhi për ballë dhe drejtuesi me skafandër të zezë qëlloi në drejtimin tonë. Jam ulur dhe dëgjova vetëm zhurmën e plumbave që shponin trupin e Nardit". Kështu ka deklaruar në polici pronari i servisit të makinave, Xhovan Mirashi, i cili i mbijetoi atentatit ku mbeti i vrarë 35-vjeçari Ferdinand Polia. Mësohet se Mirashi dhe biznesmeni nga Thethi, Polia ishin shokë të hershëm dhe shpeshherë ky i fundit ia linte makinën për t'i bërë shërbime. Sipas abcnews.al, dëshmitari ka deklaruar se shoku i tij nuk kishte probleme. "Nuk di për ndonjë ngatërresë, apo që të kishte ndonjë konflikt", është shprehur para oficerëve të policisë gjyqësore Mirashi. Të njëjtën gjë bëjnë me dije dhe burime nga policia e Shkodrës. Nuk janë regjistruar konflikte të ekspozuara të viktimës, dhe kjo e ka bërë punën edhe më të vështirë për grupin hetimor. 35-vjeçari, ishte duke shkuar në drejtim të Shkodrës kur u bë atentat, ai ishte babai i një vajze, ndërkohë bashkëshortja e tij ishte shtatzënë, pronar bujtine në Theth, por edhe punonjës i Agjencisë së Zonave të Mbrojtura. Sipas Xhovan Mirashit, vrasësi fillimisht ka dalë përpara makinës dhe ka qëlluar dy herë në drejtim të tij. Makina ka ndaluar disa metra më poshtë, ku ekzekutori përsëri u afrua dhe qëlloi mbi Nardin e Bujtinave, i njohur edhe si "Ranges", edhe disa herë të tjera. Fatmirësisht, asnjë plumb nuk preku shokun e viktimës, i cili ishte në vendin e parë të makinës. Autori ka përdorur automatik tip "Scorpions". Ekspertët kanë gjetur 20 gëzhoja në vendin e ngjarjes, kurse në trupin e viktimës 18 plumba. "Kemi të bëjmë me një killer profesionist e gjakftohtë", pohuan hetuesit, të cilët po merren me ngjarjen e ndodhur pasditës së të mërkurës. Mësohet se në kohën kur ka ndodhur vrasja, në vendin e ngjarjes ka patur dëshmitarë, banorë të zonës që ndodheshin nëpër oborret e shtëpive të tyre. Atentatori ka parë të gjithë banorët, por kjo nuk e ka penguar

"Vrasësi doli para makinës, u ula dhe dëgjova zhurmën e plumbave që shponin trupin e Nardit"

Pronari i servisit, Xhovan Mirashi: S'kishte probleme. Hetuesit: Autori, killer profesionist dhe gjakftohtë



35-vjeçari i vrarë, Ferdinand Polia



Drejtori i AZM në Shkodër, Agim Dardha

18

PLUMBA
Ekspertët kanë gjetur 20 gëzhoja në vendin e ngjarjes, kurse në trupin e viktimës 18 plumba. Mësohet se në kohën kur ka ndodhur vrasja, në vendin e ngjarjes ka pasur dëshmitarë, banorë të zonës që ndodheshin nëpër oborret e shtëpive të tyre. Atentatori ka parë të gjithë banorët, por kjo nuk e ka penguar ta ekzekutojë "Rangesin" brenda pak minutave.

ta ekzekutojë "Rangersin" brenda pak minutave.

Një ditë pas ngjarjes së rëndë të ndodhur në fshatin Grudë të njësisë administrative Gruemirë, drejtori i Administratës të Zonave të Mbrojtura (AZM) në Shkodër, Agim Dardha ka treguar dje për mediat takimin me "Nardin e bujtinave" pak para se të ekzekutohej në atentat.

RRËFIMI I AGIM DARDHES

Takim që sipas tij ka kaluar mes batuatave dhe humorit, ndërkohë që ai nuk kishte shfaqur asnjë shqetësim. Dardha tha se nuk kishte vënë re asnjë shqetësim në sjelljen e tij. Ai tregon, gjithashtu, se ka takuar pasditën e së mërkurës, rreth orës 13:30. "Është një humbje e madhe për institucionin tonë, gjithë familjen, të afërmit dhe ata që e njohën. Kemi kaluar shumë kohë të mira me të dhe gjithmonë ka qenë vetëm me humor dhe i qeshur. Dje e takuam për herë të fundit teksa kemi konsumuar një kafë rreth orës 13:30. Ishte si zakonisht i qeshur dhe me batuta. Nuk vërejtëm asnjë shqetësim

RRËFIMI I TË MBIJETUARIT TË ATENTATIT

Sipas pronarit të servisit të makinave, Xhovan Mirashi, vrasësi fillimisht ka dalë përpara makinës dhe ka qëlluar dy herë në drejtim të tij. Makina ka ndaluar disa metra më poshtë, ku ekzekutori përsëri u afrua dhe qëlloi mbi Nardin e Bujtinave, i njohur edhe si "Ranges", edhe disa herë të tjera. Fatmirësisht, asnjë plumb nuk preku shokun e viktimës, i cili ishte në vendin e parë të makinës. Autori ka përdorur automatik tip "Scorpions".

tek sjellja e tij apo ndonjë problem. Ishte normal si çdo ditë tjetër." - u shpreh drejtori Dardha. Nga ana tjetër, Age Martini, specialiste e Zonave të Mbrojtura Shkodër tha në ceremoni se pak para vdekjes së tij e ka takuar, ndërsa nuk ka vënë re asnjë lloj shqetësimi. "E kemi njohur si një djalë shumë të mirë. I shprehim ngushëllimet tona më të sinqerta familjes. Për herë të fundit konsumuam një kafë me të një ditë më parë. Ishte ashtu si zakonisht i qeshur dhe me sjelljen e tij që e ka karakterizuar dhe që e kanë njohur të gjithë. Ne dje po diskutonim planet për të ardhmen dhe për turizmin dhe nuk kemi vërejtur asnjë lloj shqetësimi apo problemi tek ai. Ishte si gjithmonë", - u shpreh kolegja e tij.

Shkrumbohet makina pranë gjykatës, policia dyshon për zjarrvënien të qëllimshme

VLORE - Nuk ka të ndalur seriali i djegies së automjeteve në qytetin e Vlorës, ku shumica e të cilëve kanë rezultuar të qëllimshme. Një makinë tip "Fuoris-tradë" është përfshirë nga flakët, rreth orës 4 të mëngjesit të djeshëm, shumë pranë Gjykatës së Vlorës. Me të marrë njoftim, policia ka shkuar në vendngjarje dhe ka nisur hetimet me dyshimet e para që flasin për zjarrvënien të



qëllimshme. Mësohet se automjeti rezultoi në pronësi të shtetasit 50-vjeçar, R.M., i

cili është marrë në pyetje nga policia për ndonjë konflikt të mundshëm. Ndërkaq, hetuesit kanë nisur kontrollin e kamerave të sigurisë përreth zonës ku u dogj automjeti, në përjekje për të zbuluar autorin apo autorët e mundshëm të saj. Ky nuk është rasti i parë i djegies së qëllimshme të makinave në Vlorë, teksa deri më tani, asnjë autor i rasteve të mëparshme nuk është zbuluar nga policia.

"Keni kompromentuar rëndë integritetin dhe paanshmërinë e hetimit"

Fondet për lobim në SHBA, kryedemokrati Basha letër prokurorisë: Propagandë politike

"Kërkesa për paraqitje e pambështetur në ligj, në asnjë standard profesional dhe etik të hetimit"

TIRANË

Kryetari i Partisë Demokratike, Lulzim Basha i është përgjigjur përmes një letre prokurorisë së Tiranës, e cila ditën e djeshme e kishte futur atë të paraqitje, lidhur me kontratat e lobimit të Partisë Demokratike në SHBA. Së bashku me ish-sekretarin e përgjithshëm Arben Ristani, Basha ishte ftuar nga organi i akuzës për t'u njohur me përgjigjen e letërporosisë së SHBA-ve për çështjen në fjalë. Përmes letrës, Basha e konsideroi kërkesën e paraqitjes në prokurori të pambështetur në ligj dhe të pa mbështetur në asnjë standard profesional dhe etik të hetimit. Kryedemokrati bën të ditur se as ai dhe asnjë drejtues tjetër i Partisë Demokratike nuk janë marrë nën hetim dhe nuk janë të pandehur në asnjë hetim, arsye për të cilën ata nuk ka nevojë të informohen dhe prokuroria nuk ka asnjë detyrim të informojë për të dhënat e verifikimeve që po bën. Basha shpjegon se zyrtarët e PD-së janë paraqitur në prokurori për të dhënë shpjegimet e tyre që ndihmojnë prokurorinë në këtë çështje. Për këtë arsye, çmohet e panevojshme paraqitja sipas njoftimit të ardhur për njohjen me aktet. "Fakti që një ftesë e tillë vjen 6 muaj pasi ju e keni marrë informacionin në fjalë dhe në një kohë kur ka filluar një fushatë keqinformimi me natyrën dhe ecurinë e hetimit në fjalë, na bën të mendojmë se veprimi juaj është bërë jo për qëllime hetimore, por për shërbime propagandistike politike", thuhet ndër të tjera në letrën e kreu të selisë blu, Lulzim Basha. Duke vënë në dukje se "me thirrjen e panevojshme, keqinformuese dhe në një kohë të përzgjedhur politikisht, ju keni kompromentuar rëndë integritetin dhe paanshmërinë e hetimit", Basha i kërkon prokurorisë së Tiranës të distancohet menjëherë nga qëndrime me prapavijë politike, si dhe të marrë të gjitha masat për të ndaluar në të ardhmen çdo lloj përdorimi për qëllime politike të hetimi.

HETIMI
Prokuroria nisi hetimet pas shkrimit në revistën amerikane "Mother Jones" lidhur me fondet që kjo parti ka paguar për aktivitetet të lobimit në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, para zgjedhjeve të qershorit 2017. Janë katër kontrata të dyshimta me vlerë rreth 600 mijë dollarë, para të cilat vijnë nga kompania "Binita Trade" pronë e dy shtetasve rusë. Paratë janë dërguar në



Kreu i PD-së, Lulzim Basha

KËRKESA

"Me thirrjen e panevojshme, keqinformuese dhe në një kohë të përzgjedhur politikisht, ju keni kompromentuar rëndë integritetin dhe paanshmërinë e hetimit. Për këtë arsye, ju kërkoj të distancoheni menjëherë nga qëndrime me prapavijë politike dhe të merrni të gjitha masat për të ndaluar në të ardhmen çdo lloj përdorimi për qëllime politike të hetimit që po zhvilloni", shkruhet në letër.

PARTIA DEMOKRATIKE E SHQIPËRISË
KRYETARI

Partia Demokratike e Shqipërisë

Nr. 39 Prot.

Tiranë, më 20 Mars 2019

Lënda: Kthim përgjigje

DREJTUAR: Znj. Elisabeta Imeraj – Drejtuese e Prokurorisë PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TIRANË

PËR DIJENI: Z. Gjergji Tako, Prokuror pranë Prokurorisë së Shkallës Parë Tiranë

E nderuar znj. Drejtuese e Prokurorisë,

Në përgjigje të shkresës nr. 4135 Prot., datë 18.03.2019 të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, me anë të së cilës përcillet urdhri juaj për paraqitjen për njohje me aktet e ardhura nga Departamenti i Drejtësisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe nga Autoriteti i Drejtësisë së Skocisë, për z. Arben Ristani, z. Gazment Bardhi, z. Ilir Dervishi dhe z. Lulzim Basha, ju bëjmë me dije sa më poshtë vijon:

Jam i habitur nga thirrja juaj për t'u paraqitur pranë zyrave tuaja për t'u njohur me një informacion që ju paskeni marrë në kuadër të hetimit që ju po zhvillon në lidhje me respektimin e ligjit në deklarimet financiare të Partisë Demokratike.

Kjo kërkesë e juaja është e panevojshme, e pa mbështetur në ligj dhe e pa mbështetur në asnjë standard profesional dhe etik të hetimit.

As unë, asnjë drejtues tjetër i Partisë Demokratike dhe as Partia Demokratike nuk janë marrë me **Faksimile e letrës dërguar prokurorisë** asnjë hetim, prandaj as unë dhe as një drejtues tjetër i Partisë Demokratike nuk ka nevojë dhe nuk keni asnjë detyrim ta na informoni për asnjë të

Hetimi për lobimin, Balla: Refuzimi i Bashës, frikë nga reforma në drejtësi

TIRANË - Mosparaqitja e kryedemokratit Lulzim Basha në prokurorinë e Tiranës ka pasuar me reagimin e kryetarit i grupit parlamentar socialist, Taulant Balla. Duke folur në Kuvend për situatën e dhunës opozitare në ambientet e jashtme, për të cilat akuzoi Lulzim Bashën si përgjegjës, nxitës dhe orkestrues, Balla, foli edhe për një çështje të rëndësishme të ditëve të fundit, atë të hetimit të lobimit demokrat në Shtetet e Bashkuara me paratë të dyshuara me origjinë ruse. "Sot u njohëm me refuzimin e kryetarit të PD-së për t'u paraqitur në insti-



tucionin e prokurorisë. E kemi thënë para pak javësh, që po i lënë mandatet, sepse e kanë hallin in reforma në drejtësi, por një pjesë e atyre që paguhen për të dhënë opinionetë thanë: 'ç'lidhje ka kjo reformë me lënien e mandateve. Sot shqiptarët kanë

marrë përgjigjen", tha Balla. "Lulzim Basha refuzoi të paraqitet këtë të enjte përpara prokurorëve për një hetim. Ky është rasti i parë sesi kryetari i opozitës, pasi ka lënë mandatin për hir të interesave të vendit dhe jo për të bllokuar reformën në drejtësi, nuk respekton detyrimin që ka çdo shtetas, nga Presidenti i Republikës deri te më i thjeshti", tha Balla. Arsyetimin e bërë sot publik për këtë refuzim, Balla e quan mosarsyetim. "Hetimi nuk po kryhet vetëm nga Prokuroria shqiptare, por po kryhet njëkohësisht edhe nga Departamenti i Drejtësisë së Sh-

teteve të Bashkuara të Amerikës dhe nga autoriteti i drejtësisë së Skocisë. Si mund të guxojë dhe të pretendojë besimin e shqiptarëve, kur Prokuroria e njofton për ta marrë në pyetje për një çështje që i ka lënë gojëhapur miqtë tanë perëndimorë, sesi kryeministri në hije paskësh qenë dy vite më parë i sponsorizuar me paratë që nga hetimi i medieve amerikane shkojnë në 950 mijë dollarë, nga të cilat Basha justifikon as 10 për qind të tyre. 90 përqindëshi nuk ka dalë nga Shqipëria, nuk ka dalë nga financat e PD-së", tha Balla.

logaritë e kompanisë së Nikolas Muzin, i cili ka mundësuar takime të kryetarit të Partisë Demokratike Lulzim Basha me administratën e Presidentit amerikan apo zyrtarë të lartë atje. Sipas deklarimeve të kompanisë 'Muzin' ajo ka marrë tri pagesa, në një shumë prej 675

mijë dollarësh, për punën e saj në favor të Partisë Demokratike në vitin 2017: pagesa e parë mban datën 24 mars 2017 dhe është bërë nga firma 'Biniatta Trade LP', me një vlerë prej 150 mijë dollarësh, dy pagesat e tjera janë bërë nga Partia Demokratike, njëra më 27 mars, për 25 mijë

dollarë, dhe tjetra më 9 qershor për 500 mijë dollarë. Nga këto deklarime të firmës Muzin, vetëm ajo prej 25 mijë dollarësh, është pranuar nga kryetari i PD-së, Lulzim Basha që është paguar nga PD-ja. Partia Demokratike nuk ka pranuar asnjë lidhje me firmën 'Biniatta Trade LP', e

cila rezulton e regjistruar në Edinburg të Skocisë dhe është në pronësi të një zinxhiri kompanish të regjistruara në Belize - një shtet i Amerikës Qendrore, i njohur si parajsë fiskale. Vetë kryedemokrati prej nëntorit të vitit të kaluar ftoi prokurorinë të hapë hetimet për të sqaruar çështjen.

Vrasja e Devi Kasmit, dështon seanca ndaj specialist grek Eftimius Eftimiu

TIRANË - Seanca e parë gjyqësore ndaj specialist grek Eftimius Eftimiu dhe katër të pandehurve të tjerë, të akuzuar për vrasjen e Devi Kasmit rreth një vit më parë ka dështuar. Shkak është bërë mos marrja e dëgjimit të pandehurit Aurel Hoxhallari, i arratisur prej një viti, ndërsa Gjykata për Krime të Rënda vendosi të kërkojë ndihmën e Interpol Tiranë për të bërë të mundur gjetjen dhe njoftimin e tij. Ndërkohë, avokati i zgjedhur nga familja e të pandehurit, Samir Vishaj, kërkoi ndarjen e çështjes dhe vazhdimin e gjyqimit për pjesë tjetër të grupi dhe të mos bëhet kjo, pengesë. Ngjarja e rëndë, për të cilën si ekzekutor akuzohet shtetasi grek, ka ndodhur në 29 janar 2018, poshtë banesës së viktimës Devi Kasmit. Eftimiu, sipas prokurorisë, është ndihmuar nga të pandehurit e tjerë për të kryer krimin, i cili dyshohet se është porositur nga Aurel Hoxhallari.

"Investim 12 milionë lekë për laboratorin"

Analizat e ADN-së falas, Manastirliu: Të zbulohen në kohë diagnozat prenatale

Analiza e ADN dhe një seri analizash për zbulimin e diagnozave paralinjës, tashmë do të ofrohen falas në strukturat publike. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale Ogerta Manastirliu, në Ditën Ndërkombëtare të Sindromës Down, ka ndarë lajmin për rihetimin e Laboratorit të Diagnozës Molekulare, me një investim prej 12 milion lekësh nga buxheti i shtetit, në aparatura të fjalës së fundit të teknologjisë. "Rihetimi i laboratorit të Diagnozës Molekulare në Ma-

ternitetin 'Mbretëresha Geraldine', bën të mundur realizimin e disa analizave shumë të rëndësishme për sa i përket diagnozave prenatale, siç janë analiza e AND-së dhe një seri analizash të tjera për diagnozat prenatale që do të kryhen në sajë të këtij investimi" tha Manastirliu.

Aparaturat e instaluar në këtë laborator, do të ofrojnë 4-fishin e analizave të

diagnozës prenatale. Manastirliu deklaroi se përveç këtij investimi, janë shtuar analiza të reja edhe në laboratorin e gjenetikës në QSUT, siç është ekzaminimi i kariotipit, duke filluar nga janari i këtij viti, të cilat ndihmojnë në dhënie të shërbimeve që nuk ofrohen më parë, për identifikimin e diagnozave gjenetike.

"Mbështesim sa më shumë zhvillimin dhe

mirërritjen e fëmijëve, por edhe të familjeve, duke ofruar këto analiza - të cilat deri dje paguheshin - sot janë falas, nëpërmjet sistemit të referimit dhe protokolleve të miratuara në sistemin publik", u shpreh Manastirliu.

Me një investim prej 12 milionë lekësh nga buxheti i shtetit në aparatura dhe në kite-reagentë, laboratorit i gjenetikës në maternitetin "Mbretëresha Geraldinë"



është i vetmi laborator publik që do të kryejë analizat e diagnozës prenatale: Trisomia 21, ose siç njihet ndryshe Sindroma Down; Fibro-

za cistike; Talasemite major; Kryerja e ADN apo patologji të tjera që do të diagnostikohen që në barkun e nënës.

Instituti i Sigurimeve Shoqërore: Si bëhet rishqyrtimi i masës së pensionit

Lehtësohet procedura e marrjes së pensioneve të pleqërisë, ja ku mund t'i tërhiqni

Procedura e re e transferimit të dosjeve nga një drejtori në tjetrën

Të moshuarit do të mund t'i tërheqin pensionet e pleqërisë në çdo sportel të Postës Shqiptare. Ky lehtësim që do të prekë mijëra pensionistë në mbarë vendin, është arritur falë bashkëpunimit mes Instituti të Sigurimeve Shoqërore dhe Postës Shqiptare, pas informatizimit të sistemit të pagesave. "Të gjithë pensionistët, tashmë mund ta tërheqin shumën e përfutur nga pensioni i pleqërisë në çdo sportel të Postës Shqiptare. Me përfundimin e procesit të ndërtimit të bazës së të dhënave elektronike të pensione, informatizimin e sistemit të pagesave dhe të procesit të kontrollit të tyre, është bërë e mundur lehtësimi i procedurave të transferimit të qendrës paguese të pensionit, pavarësisht nga vendbanimi, sipas regjistrimit të gjendjes civile", bën me dije Posta Shqiptare.

TRANSFERIMI I DOSJEVE

Gjithashtu, në kuadër të këtyre ndryshimeve, tashmë është lehtësuar edhe transferimi i dosjes së pensionit nga një Drejtori Rajonale e Sigurimeve Shoqërore në tjetrën. Sipas procedurës, fillimisht qytetari duhet të dorëzojë kërkesën pranë Agjencisë Lokale të Sigurimeve Shoqërore ku dëshiron të transferojë dosjen e tij, ndërkohë që kërkesën për pagesën e pensionit mund ta bëjë edhe pranë zyrës postare, ku ai do që të tërheqë pensionin. "Ky projekt po aplikohet fillimisht si projekt pilot në zyrat postare të Filialit të Postës Tiranë, për t'u shtrirë më pas edhe në Filialet e tjera", thekson Posta Shqiptare. Këto lehtësira u krijuan si pasojë e përfundimit të procesit të ndërtimit të



bazës së të dhënave elektronike dhe unike të pensione, informatizimin e sistemit të pagesave dhe të procesit të kontrollit të tyre. Zbatimi i kësaj procedure të thjeshtuar të transferimit të qendrës së pagesës shkurtin kohën, si dhe vetëgarkon strukturat e ISSH-së për të kryer procedurat e transferimit dhe njoftimin e qytetarit.

RISHQYRTIMI I MASËS

Pas marrjes së vendimit të caktimit të pensionit, përfutuesi ka të drejtë të aplikojë për rishqyrtim pensioni për të dorëzuar dokumentacion shtesë, për një masë më të lartë

përfitim ose për zgjatjen e afatit të përfutur për pensionin invalid, familjar dhe suplementar të parakohshëm. Të interesuarit duhet të regjistrohen si qytetar në portalin e albania dhe të plotësojnë formën përkatëse për këtë kërkesë, e cila do të hapet menjëherë pas klikimit të butonit "Përdor" në krah të këtij shërbimi. Më tej në portal bëhet me dije se numri i sigurimit plotësohet paraprakisht në momentin që aplikanti hyn në portal me kredencialet e tij përkatëse. Ndërkohë të gjithë aplikantët pasi të kenë përdorur këtë shërbim elektronik, duhet të

paraqiten në zyrat e agjencive lokale për të dorëzuar dokumentacionin e kërkuar: **DOKUMENTET QË NEVOJITEN**

Dokumentet e nevojshme për rishqyrtim janë në varësi të objektivit të rishqyrtimit. Por aplikantët duhet të kenë parasysh që të dorëzojnë një kopje të kartës së identitetit ose certifikatë personale; një certifikatë familjare; vërtetim për pagat pas vitit 1993; vërtetim nga arshiva e ISSH-së, DRSSH-së për vjetërsi në punë; vërtetim për kontributet si i vetëpunësuar në bujqësi; vërtetim për kohën e kryerjes së shërbimit ushtarak; vërtetim

KËRKESA

Është lehtësuar edhe transferimi i dosjes së pensionit nga një Drejtori Rajonale e Sigurimeve Shoqërore në tjetrën. Sipas procedurës, fillimisht qytetari duhet të dorëzojë kërkesën pranë Agjencisë Lokale të Sigurimeve Shoqërore ku dëshiron të transferojë dosjen e tij, ndërkohë që kërkesën për pagesën e pensionit mund ta bëjë edhe pranë zyrës postare, ku ai do që të tërheqë pensionin.

INFORMATIZIMI

"Me përfundimin e procesit të ndërtimit të bazës së të dhënave elektronike të pensione, informatizimin e sistemit të pagesave dhe të procesit të kontrollit të tyre është bërë e mundur lehtësimi i procedurave të transferimit të qendrës paguese të pensionit, pavarësisht nga vendbanimi, sipas regjistrimit të gjendjes civile", bën me dije Posta Shqiptare.

nga shkolla, kur fëmija është 18 vjeç - 25 vjeç; vërtetim nga Tatim Taksat për pjesëtarët që ka në ngarkim; si dhe një vërtetim nga Zyra e Punës si punëkërkuar. Ndërkohë të interesuarit duhet të dorëzojnë edhe një fotokopje të kontratës me KESH-in; dëshminë e penalitetit për të përndjekurit politikë; vërtetim i kohës së vuajtjes së dënimit (të përndjekurit politikë); diplomën e shkollës së lartë; fletëdrejtimi për në KMCAp dhe fletëdaljet nga spitali; analiza mjekësore sipas diagnozës; vërtetim identiteti; aktverifikim; vendim gjykatë; deklaratat individuale për punësim (e përvitshme) mod.

09; si dhe një deklaratë individuale që nuk është i punësuar (mod. 08). Gjithashtu pensionistët duhet të paraqesin pranë zyrave përkatëse edhe: vërtetim i pagës referuese mod. nr.02; vërtetim i pagës mesatare referuese mod. nr.03; vërtetim i viteve të shërbimit mod. nr.03; vërtetim për derdhje të kontributit suplementar nr.08; vërtetim page referuese të përfutur shtetëror suplementar; vërtetim për periudhën e shërbimit në funksion apo detyrë; vërtetim për derdhje të kontributit suplementar; vërtetim i pagës referuese; si dhe një vërtetim për periudhën e shërbimit.

SHPPALLJE ANKANDI
Zyra Permbarrimore "E.G. Balliuf Service" me Përmbarrues Gjyqësor Enuar Merko me adresë Rr. "Ibrahim Rruova", Pallati 64, Hyrja 8, Ap. 1, Tiranë, njofton se më datë 03.04.2019 ora 8⁰⁰ - 16⁰⁰ në ambientet e saj, do të zhvillohet: Ankandi i për shlitjen e pasurisë së paluajtshme. Ndërtësit e sipërfaqe totale 186 m², regjistruar në Z.V.R.P.P. Shkodër me Nr.pasurie 2/613+1-6. Volumi 37, Faqe 232, Zona Kadastrale Nr. 8591 në pronësi të Z.Alfred Lec Mazi me vlerë fillestare në ankand 100.000 (njëqind mijë) EURO. Të interesuarit të kontaktojnë në nr. e telefonit 0672027580, +355 4 22 31 888. email enuar.merko@gmail.com;

NJOFTIM SHITJE ME ANKAND
Përmbarrimi Gjyqësor Privat "Jon 2014", me përmbarruese Jonida Ujkashi do të zhvillojë Ankandin e dytë për pasurinë: 1- Trull¹, me sipërfaqe 250 m² dhe sipërfaqe ndërtëse 85m², e ndodhur në Bitinckë, Devoli, në Zonën Kadastrale 1202, Numri i Pasurisë: 1831/50, Vol. 20, Faqe. 70, në pronësi të Vasil Ferit Muzeku. Çmimi me të cilin filon shitja e kësaj pasurie është në vlerën e 5,600 (pesmije e gjashtëqind) EURO ose 700,000 (shtatëqind mijë) LEKË. Ankandi i dytë për pasurinë e mesipërme zhvillohet me datë 17.04.2019, ora 16:00 në ambientet e Zyrës së përmbarruese gjyqësore private Jonida Ujkashi me adresë: Rr. "Myslym Shyri", vlla nr.8/1,kt.4,Tiranë, nr.kontakti 0699381883.

Shitje me Ankand të dytë nga Studio Permbarrimore L.D.C
- "Trull¹ + ndërtëse" me nr. pasurie 286/5/1, vol.3, faqe 36, Zona Kadastrale. 3866, me sipërfaqe totale 300 m², regjistruar në Z.V.R.P.P. Tiranë. Çmimi fillestar për shitje është 1.800.000 Leka.
Data e shpalljes 27.02.2019
Data e zhvillimit 28.03.2019 deri në orën 16.00
Ankandi zhvillohet në ambientet e Studios Permbarrimore L.D.C me adresë Rruga "Myslym Shyri" Vila 8/1, kati 1 Tiranë.

Përfaqësuesit e 'LMU University': Reformat e korrupsioni në Shqipëri, anëtarësimi në BE

Reforma në drejtësi dhe integrimi në BE, studentët gjermanë te "Luarasi"

Vishaj: Pasuritë e gjyqtarëve, të kontrollueshme

Voltiza Duro

Reforma në drejtësi është një nga kushtet kryesore që Shqipëria duhet të plotësojë për t'u bërë pjesë e familjes europiane. Në kuadër të kësaj çështjeje, universiteti 'Luarasi' zhvilloi një bashkëpunim me një grup studentësh gjermanë. "Reforma në Drejtësi dhe Integrimi European" ishte tema rreth së cilës u diskutua dhe madje u propozuan edhe zgjidhje për përshtetimin anëtarësimi të vendit tonë në BE. Saimir Vishja, avokati njohur, njëkohësisht pedagog i së drejtës penale ka folur mbi skemën e re të emërimit të gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese. "Deri më sot i kemi quajtur si të paprekshëm, si gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, ashtu edhe deputetët. Dhe ata që binin në burg ishin pjesë e popullit të varfër. Aktualisht kemi ndryshuar edhe sistemin e lartë të Drejtësisë që është Gjykata Kushtetuese. Më përpara kjo gjykatë kishte ndikim politik pasi zgjidhej nga parlamenti dhe presidenti. Këtu kemi një skemë të re sesi emërohen gjyqtarët e Kushtetueses, e cila përbëhet nga 9 anëtarë me të drejtë ripërsëritjeje një herë në 3 vjet", tha Vishaj. Ky i fundit shtoi se pasuritë e këtyre gjyqtarëve dhe familjarëve të tyre do të jenë lehtësisht të kontrollueshme. "Këta gjyqtarë duhet të heqin dorë nga privatësia. Së pari, pasuritë e gjyqtarëve të Kushtetueses do të jenë lehtësisht të kontrollueshme. Së dyti, edhe familjarët e tyre do të jenë nën kontroll dhe duhet të lejojnë çdo lloj veprimi procedural ndaj tyre. Në këtë mënyrë çdo pasuri e vënë në mënyrë të kundërligjshme nga këta gjyqtarë, do t'i nënshtrohet



Takimi mes studentëve të 'Luarasit' dhe përfaqësuesve të universitetit gjerman



TE RINJTE

Grupi i të rinjve gjermanë diskutuan me studentët e Juridikut mbi sistemin shqiptar të drejtësisë, reformat dhe korrupsionin. Ata analizuan së bashku edhe rolin që Shqipëria mund të ketë nëse bëhet pjesë e BE-së. "Universiteti ynë po bën një udhëtim në institucionet e arsimit të lartë në Shqipëri".

KONTROLLI I PASURISË

"Këta gjyqtarë duhet të heqin dorë nga privatësia. Së pari, pasuritë e gjyqtarëve të Kushtetueses do të jenë lehtësisht të kontrollueshme. Së dyti, edhe familjarët e tyre do të jenë nën kontroll dhe duhet të lejojnë çdo lloj veprimi procedural ndaj tyre", - bëri me dije pedagogu i së Drejtës Penale në universitetin "Luarasi", Saimir Vishaj.



ANËTARËSIMI NË BE

"Universiteti ynë po bën një udhëtim në institucionet e arsimit të lartë në Shqipëri. Jemi në universitetin 'Luarasi' për të folur me studentët për sistemin e drejtësisë në Shqipëri, e veçanërisht për reformat dhe korrupsionin. Jemi këtu për të dhënë disa opsione që vendi juaj t'i bashkohet BE-së", - tha njëri prej studentëve gjermanë.



PROGRAMET E "LUARASIT"

"Dëshironim të flisnim me studentët dhe profesorët shqiptarë për të ardhmen e Shqipërisë. Jemi këtu për të analizuar rolin që mund të luajë Shqipëria nëse bëhet pjesë e familjes europiane. Zgjidhëm të vizitonim këtë universitet, pasi shfaqëm interes për programin që ai ofron në fushën e drejtësisë", - u shpreh studenti tjetër i 'LMU University'.



ligjit", bëri me dije pedagogu i së Drejtës Penale në universitetin "Luarasi".

STUDENTËT

Grupi i të rinjve gjermanë diskutuan me studentët e Juridikut mbi sistemin shqiptar të drejtësisë, reformat dhe korrupsionin. Ata analizuan së bashku edhe rolin që Shqipëria mund të ketë nëse bëhet pjesë e BE-së. "Universiteti jonë po bën një udhëtim në institucionet e arsimit të lartë në Shqipëri. Ne jemi nga Gjermania dhe sot jemi në universitetin 'Luarasi' për të folur me studentët për sistemin e drejtësisë në Shqipëri, e veçanërisht për reformat dhe korrupsionin. Jemi këtu për të dhënë disa opsione për implementimin e elementëve që vendi juaj t'i bashkohet BE-së", - tha njëri prej studentëve gjermanë. Ndërkohë një tjetër përfaqësues i universitetit

LMU në Gjermani vlerësoi programet e aplikuar në fushën e drejtësisë në Fakultetin Juridik në 'Luarasi'. "Dëshironim të flisnim me studentët dhe profesorët shqiptarë për të ardhmen e Shqipërisë dhe mundësinë për të qenë pjesë e Bashkimit European. Gjithashtu, jemi këtu për të analizuar rolin që mund të luajë Shqipëria nëse bëhet pjesë e familjes europiane. Zgjidhëm të vizitonim këtë universitet pasi shfaqëm interes për programin që ai ofron në fushën e drejtësisë", - u shpreh studenti tjetër i LMU University. Gjithashtu, përfaqësuesit e universitetit LMU në Gjermani thanë se ky aktivitet do të pasohet nga bashkëpunime të tjera me 'Luarasin'.

REPUBLIKA E SHQIPERISE
BANKA E SHQIPERISE
DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT
SEKTORI I PROKURIMIT

TENDER I HAPUR KOMBËTAR

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: **"Blerje pjesë këmbimi, mirëmbajtje dhe riparim i automjeteve të Bankës së Shqipërisë për një periudhë një vjeçare"**

"Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me **fond limit 4,000,000 Lekë**".

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Haliili", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411 (ext. 1844), çdo ditë nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraprakisht pagesën e paktyshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në llogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfutuesi: Banka e Shqipërisë
BIC: STANALTR
IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: **"Blerje pjesë këmbimi, mirëmbajtje dhe riparim i automjeteve të Bankës së Shqipërisë për një periudhë një vjeçare"**
Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më datë **15 Prill 2019, ora 11:00**, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.

REPUBLIKA E SHQIPERISE
BANKA E SHQIPERISE
DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT
SEKTORI I PROKURIMIT

TENDER I HAPUR KOMBËTAR I SHOQERUAR ME FTESA
DIREKTE KANDIDATEVE TE HUAJ

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: **"Shtypje e monedhave metalike përkujtimore për qëllime numizmatike '200 Lekë' dhe '100 Lekë', pa kurs ligjor, për nevojat e Bankës së Shqipërisë"**

"Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar i shoqeruar me ftesa direkte kandidatëve të huaj", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me **fond limit 54,345,000 Lekë**".

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Haliili", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411 (ext. 1844), çdo ditë nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraprakisht pagesën e paktyshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në llogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfutuesi: Banka e Shqipërisë
BIC: STANALTR
IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: **"Shtypje e monedhave metalike përkujtimore për qëllime numizmatike '200 Lekë' dhe '100 Lekë', pa kurs ligjor, për nevojat e Bankës së Shqipërisë"**
Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më datë **19 Prill 2019, ora 11:00**, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.

Ndërtuan në tokën e shtetit ose të të tretëve, marrin tapitë për tokën

Lista me 600 pronarë që u miratohet e drejta mbi truallin

Përfituesit Tiranë, Shkodër, Durrës, Elbasan dhe Korçë

Miratohet lista me personat që kanë ndërtuar pa leje dhe fitojnë të drejtën e pronësisë mbi sipërfaqet ndërtimore. Me një vendim të veçantë, qeveria ka përcaktuar metra katrorë për parcelat ndërtimore në Tiranë, Shkodër, Durrës, Elbasan dhe Korçë. Janë 600 përfitues në të gjithë vendin, të cilët do të marrin tapitë për truallin mbi të cilin kanë ndërtuar. Në listën e miratuar nga qeveria janë përcaktuar sipërfaqet për çdo përfitues, ndërsa ngarkohet ALUIZNI për pasqyrimin e tyre në dokumentet përkatese. Përfituesit do të mar-

rin tapitë për sipërfaqet e përcaktuara në VKM, pavarësisht sipërfaqes që kanë deklaruar në procesin e vetëdeklarimit të ndërtimit pa leje. Përfituesit kanë mbyllur të gjithë detyrimet dhe

pritet të marrin tapinë për tokën.
KALIMI I PRONËSISË
Kalimi i së drejtës së pronësisë mbi parcelën ndërtimore të objektit pa leje bëhet sipas dispozitave të

Kodit Civil. Sipërfaqja e parcelës për të cilën miratohet kalimi i së drejtës së pronësisë nuk mund të jetë më e madhe se trefishi i sipërfaqes së bazës së ndërtimit dhe për ndërtimet pa leje me funk-

sion banimi jo më shumë se 500 m². Sipërfaqet mbi masat e përcaktuara në këtë pikë, të cilat për shkak të përmasave ose konfiguracionit nuk mund të shfrytëzohen më vete për ndërtim i shiten

poseduesit të ndërtimit pa leje sipas vlerës së pronës, të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave, vetëm nëse ka shprehur më parë vullnetin nëpërmjet një kërkesë me shkrim.

PRONARËT QË U MIRATOHET E DREJTA MBI TRUALLIN

QARKU TIRANË, ZONA KADASTRALE 8310, ZVRPP				
203	RAIMON SKENDE	SHEHI		120.30
	SKEND ISMAIL	SHEHI		
QARKU TIRANË, ZONA KADASTRALE 8270, ZVRPP				
204	LIRI HEKURA	METUSHI		53.90
	KLODIA BESIM	DULE		
	EDUAR BESIM	METUSHI		
	ALKETA BESIM	RRYTA		
	ARQILE MILO	QENDRO		
205	HEKTO SKENDE	JANINA		21.10
	PASAZH			
	SOKO ZIVER	MEKO		
	FATOS SHEMSH	ÇELO		
	ARBE AHMET	TIRANA		
	HAJRIJE HASAN	SHAJAKU		
	FERID ALI	SHAJAKU		
QARKU TIRANË, ZONA KADASTRALE 8220, ZVRPP				
214	NATASH MURAT	ÇIÇAJ		49.50
215	NATASH MURAT	ÇIÇAJ		2.70
QARKU TIRANË, ZONA KADASTRALE 8170, ZVRPP				
216	MERSI ZYBER	MAKNORI		26.70
	JETMI LLAQI	ÇUKO		
	JETMI LLAQI	ÇUKO		
	JETMI LLAQI	ÇUKO		
	MERSI ZYBER	MAKNORI		
	TOMORR RIZA	LAMÇE		
QARKU TIRANË, ZONA KADASTRALE 8230, ZVRPP				
DREJTORIA E ALUIZNI-T ZONAT TURISTIKE				
QARKU SHKODER, ZONA KADASTRALE 3072, ZVRPP				
219	ALDO LEONAR	XHANEJ		191
220	HIL MARK	GURI		500
221	FAZ TAHIR	SHABAJ		227
	ADRJAN FAZ	SHABAJ		
	EDUAR FAZ	SHABAJ		
	ANTO GJOKË	NIKOLLI		
	PREK GJEKË	DOSHI		
222	ANTO GJOKË	NIKOLLI		533
223	PREK GJEKË	DOSHI		926.91
224	NIKË TOMË	BUNAJ		165
225	MYFIT ALI	HYSA		164
226	NIKOLL FRAN	NDREJAJ		191.41
227	ASTRI TEFIK	ZAGANJORI		137.54
228	ASLLAN DAC	RAMAJ		300.64
229	PALE TOME	LEKA		416.96
QARKU LEZHË, ZVRPP LEZHË, ZONA KADASTRALE				
230	LAZËR PALOKË	GJINI		213
	VERONI FILIP	GJINI		
	PAULI LAZËR	GJINI		
	LAZËR PALOKË	GJINI		
	VALENTI LAZËR	MARKU		
231	PAULI LAZËR	GJINI		126.75
232	LAZËR PALOKË	GJINI		404.7
233	VALENTI LAZËR	MARKU		322.97
	LAZËR PALOKË	GJINI		
DREJTORIA E ALUIZNI-T KORÇË				
QARKU KORÇË, ZVRPP KORÇË, ZONA KADASTRALE 2				
234	DHIMIT ILIA	XHIMA		167.15
235	ELENA MIHO	XHIMA		
QARKU KORÇË, ZVRPP KORÇË, ZONA KADASTRALE 8				
236	KOSTAN GURI	JORGALLI		111.5
QARKU KORÇË, ZVRPP DEVOLE, ZONA KADASTRALE				
237	VISAR LAMBI	BEGOLLI		108.7
QARKU KORÇË, ZVRPP POGRADEC, ZONA KADASTRA				
238	MEHME FILE	MANÇELLARI		178.8
QARKU KORÇË, ZVRPP KORÇË, ZONA KADASTRALE 2				
239	NIKO FESTIM	DEMOLLARI		415
QARKU KORÇË, ZVRPP KORÇË, ZONA KADASTRALE 3				
241	RAHMI SAMI	UÇI		395
QARKU KORÇË, ZVRPP KORÇË, ZONA KADASTRALE 8				
242	GJERGJ KRISTAQ	JANAQ		277.4
QARKU KORÇË, ZVRPP KORÇË, ZONA KADASTRALE 2				
243	YLLI HYSEN	DURO		320.4
QARKU TIRANË, ZONA KADASTRALE 8340, ZVRPP				
209	SOLO NIAZI	KARAGJOZI		14.00
QARKU TIRANË, ZONA KADASTRALE 8140, ZVRPP				
210	HAMID SULEJM	REKA		19.90
	TURA MAZE	MERKO		
	GENCI GANI	REÇA		
	HAMID SULEJM	REKA		
211	TURA MAZE	MERKO		8.10
	GENCI GANI	REÇA		
QARKU TIRANË, ZONA KADASTRALE 8120, ZVRPP				
	ELISAB FETAH	HYSA		
	FATMI AQIF	DISHA		
244	ADEM MUSTA	METO		167.9
QARKU KORÇË, ZVRPP KORÇË, ZONA KADASTRALE 8				
245	KOÇO THOD	RISTO		42.75
246	LIDA SOTIR	RISTO		
QARKU KORÇË, ZVRPP POGRADEC, ZONA KADASTRA				
247	ZYBER ARIF	GUÇE		91.8
248	BUJAR ARIF	GUÇE		157.6
249	GJYLI XHELA	FEZOLLARI		241.8
250	QERIM ABEDI	GUÇE		199.8
QARKU KORÇË, ZVRPP KORÇË, ZONA KADASTRALE 8				
251	NIKO PASHK	MJEDA		34.6
252	MIHALL SOTIR	DHIMA		35.2
QARKU KORÇË, ZVRPP KORÇË, ZONA KADASTRALE 8				
253	SHABAN TEFIK	MANÇE		110.8
QARKU KORÇË, ZVRPP KORÇË, ZONA KADASTRALE 8				
254	DONIK STAVR	MUSHKA		99.12
QARKU KORÇË, ZVRPP POGRADECKORÇË, ZONA KAD				
255	Xhorxh Halit	Çuqka		500
DREJTORIA E ALUIZNI-T KUKËS				
QARKU KUKËS, ZVRPP KUKËS, ZONA KADASTRALE				
256	HALIM RAMIZ	HERENI		303.15
257	MALIK AGRO	ONUZI		498.34
258	FATRI AVNI	DOÇI		304.80
259	BLERIM AVNI	DOÇI		315.74
QARKU KUKËS, ZVRPP KUKËS, ZONA KADASTRALE				
260	ARBE OSMAN	ÇELA		282.12
261	BAJRAM AVDI	ZYBERI		321.00
262	DEFRIM SHUK	LAÇI		228.79
263	EDMON SHUK	LAÇI		185.60
264	URIM SHUK	LAÇI		149.19
265	RAAHM SHAHI	GROSHA		85.34
	XHEVRI RUFAT	GROSHA		
266	XHEVDE SAHIT	HERENI		94.29
QARKU KUKËS, ZVRPP TROPOJË, ZONA KADASTRALE				
267	PËLLUM TUSH	GJOKA		232.86
QARKU KUKËS, ZVRPP KUKËS, ZONA KADASTRALE				
268	KOMUNI MYSLIMA	I SHQIPËRISË		500.00
QARKU KUKËS, ZVRPP TROPOJË, ZONA KADASTRALE				
269	AVDYL RAM	AGAJ		149.62
QARKU KUKËS, ZVRPP HAS, ZONA KADASTRALE 3821				
270	NAIM KURT	SHURBI		366
QARKU KUKËS, ZVRPP TROPOJË, ZONA KADASTRALE				
271	Të dhënat e Pasurisë së			Sipërfaqja për kalim pronësie
	Emër	Atësi	Mbiemër	
1	2	3	4	9
271	DIOQEZ E	SAPES		500.00
QARKU KUKËS, ZVRPP KUKËS, ZONA KADASTRALE				
272	LUTFI QERIM	HALLILAJ		109.03
QARKU KUKËS, ZVRPP TROPOJË, ZONA KADASTRALE				
273	XHEM SADRI	HASANPAPA		304.80

274	SHERIF	TAHIR	BASHA	315.74
QARKU KUKËS, ZVRPP KUKËS, ZONA KADASTRALE				
275	BESIM	EMERLL	DOMI	268.69
QARKU KUKËS, ZVRPP TROPOJË, ZONA KADASTRALE				
276	AVNI	REXHE	DEGA	135.52
QARKU KUKËS, ZVRPP KUKËS, ZONA KADASTRALE				
277	REXHE	YMER	SYLA	282.69
QARKU KUKËS, ZVRPP KUKËS, ZONA KADASTRALE				
278	ASLLAN	SHABA	DOGJANI	411.85
279	NAIM	ISMAIL	MUÇMATA	317.25
QARKU KUKËS, ZVRPP KUKËS, ZONA KADASTRALE				
280	YLBER	QAZIM	ZELA	300
281	URIM	QAZIM	ZELAJ	300
DREJTORIA E ALIUZNI-I ELBASAN				
QARKU Elbasan, ZVRPP Elbasan, ZONA KADASTRALE				
282	SOFIJ	XHEMA	BASHMILI	75
	HASA	REXHE	BASHMILI	
283	RAMAZA	MUSA	KUSI	315.3
284	DYLAVE	RRAPU	SINA	354
QARKU Elbasan, ZVRPP Elbasan, ZONA KADASTRALE				
285	BANUS	YMER	KASA	396
QARKU Elbasan, ZVRPP Elbasan, ZONA KADASTRALE				
286	SOTIR	SALI	KULLA	396
QARKU Elbasan, ZVRPP Elbasan, ZONA KADASTRALE				
287	FLORE	ALI	MJRATI	500
	ALTIN	ALI	MJRATI	
288	NAZMI	IBRAHI	RRESHKA	340.2
	AISHE	KALEM	RRESHKA	
289	ANDRE	BEHEXH	MALOKU	403.3
290	ARDJAN	ISMAIL	BAJRAMI	299.7
QARKU Elbasan, ZVRPP Elbasan, ZONA KADASTRALE				
291	KASTRI	HAKI	ALLKO	327.3
QARKU Elbasan, ZVRPP Elbasan, ZONA KADASTRALE				
292	KISHA	ORTHODOKSE	AUTOQEFALE E	109.2
QARKU Elbasan, ZVRPP Elbasan, ZONA KADASTRALE				
293	ARJAN	GANI	DUZHA	267.6
294	ENGLA	MYSLI	TOROMANI	279
295	FLAMUR	JONUZ	TASHI	155.7
QARKU Elbasan, ZVRPP Elbasan, ZONA KADASTRALE				
296	ARDJAN	REXHE	BEDELI	192.3
QARKU Elbasan, ZVRPP Elbasan, ZONA KADASTRALE				
297	BARDH	ZENUN	AHMATI	248.7
	GURIJ	REFAT	AHMATI	
QARKU Elbasan, ZVRPP Elbasan, ZONA KADASTRALE				
298	SHYQY	SHERI	POKA	119.7
QARKU Elbasan, ZVRPP Elbasan, ZONA KADASTRALE				
299	ARDIT	SALI	SPAHIU	81.3
DREJTORIA E ALIUZNI-I TIRANA JUG				
QARKU TIRANE, ZVRPP TIRANE, ZONA KADASTRALE				
300	NAZMI	IDRIZ	SHOKU	300.9
DREJTORIA E ALIUZNI-I TIRANA				
QARKU FIER, ZONA KADASTRALE 3358 SH. MARINAS				
301	PANDEL	KRIST	LENA	522
302	PANDEL	KRIST	LENA	222
303	PANDEL	KRIST	LENA	972
304	PANDEL	KRIST	LENA	3278
305	PANDEL	KRIST	LENA	1408
306	PANDEL	KRIST	LENA	580
QARKU FIER, ZONA KADASTRALE 8533 ZVRPP FIER				
307	SHEHE	SULEJM	HOTI	423.3
308	TAHIR	ASLLA	HETEMAJ	427
309	HAJROS	FERIZ	KAJOLLI	286
310	HAXHI	HAMIT	ÇAKERRI	288
311	BASHKI	SHYQY	ELMAZAJ	405.9
312	BESNI	MUSTA	MALOKU	718
313	HAXHI	FEJZI	FERKO	323
314	TAHIR	ASLLA	HETEMAJ	427
315	SHEHE	SULEJM	HOTI	423.3
QARKU FIER, ZONA KADASTRALE 8532 ZVRPP FIER				
	GEZIM	SELADI	DERVISHI	450
	ARDIA	SELADI	DERVISHI	
316	MANUE	SELADI	DERVISHI	450
317	PELLUM	MYSTEH	ALUSHAJ	307
318	VALENTI	KRIST	DEVJAJ	124
319	KOZM	KOLI	GJONI	463
320	NATASH	BARJA	HEBEJA	90.5

321	ARQIL	JOTI	DASHI	240
322	VIOLETA	HARED	DURAJ	43
323	VIKTO	LONI	MLE	70
324	ADMIRI	RAPI	KERRI	276
	REDIA	RAPI	KERRI	
325	NORIS	DILAVE	DERVISHAJ	226
326	RAMAZA	FEJZU	GURGURI	219.8
327	VASIL	TODI	PRIFTI	357
328	JORGJ	PETRO	MERTIRI	290
329	ARBE	ENVER	ISUFAJ	227.8
330	PANDEL	DUD	KOLA	129.6
331	ALTIN	PANDE	MERTIRI	184
332	SOKRAT	LLAZI	KOLA	217.2
QARKU FIER, ZONA KADASTRALE 3981 ZVRPP FIER				
333	KRIST	RUSTE	SINASI	337
334	BESIM	NURE	MANAJ	374
335	FAIK	ALI	DRIZA	355
336	VLADIMI	SADIK	IDRIZAJ	331
337	AGUR	MYSTEH	HATJAJ	228
338	ALBANA	ENVER	KABASHI	258
QARKU FIER, ZONA KADASTRALE 8534 ZVRPP FIER				
339	HASA	MEMET	ELMAZAJ	317
340	BASHKI	SAFET	KAMBERAJ	500
341	SELAM	QERIM	SALAJ	103
342	MYLAZI	SABRI	GASHI	354
343	GEZIM	SELIM	HILAJ	424
344	ARBE	MATO	BUDAJ	363.2
345	LEONA	RESMI	GEGA	359
346	EDMON	MITI	PJETRI	213
347	DILAVE	ISMAIL	SHESHALLIU	340.2
348	PANDEL	DHANI	GJATA	200
349	VANGJE	LONI	KOLA	279
	LEONA	VANGJ	KOLA	
350	ERVIN	RAKO	SHTEMBARI	316.6
351	XHEVI	MUSTA	SULAJ	322
352	FASLLI	RAMO	ALUSHAJ	371
353	SHPETI	REFAT	KASA	308
354	THOM	PALI	NUSHI	405
355	LEDIO	SELAM	SALAJ	161.1
	LAURET	TODI	FILIPI	300
	GENTIA	VILSO	FILIPI	
	ENE	VILSO	FILIPI	
356	ENE	VILSO	FILIPI	300
357	KASTRI	TEKI	HADUSHAJ	297
358	ARIST	PETRI	KUQI	450
359	FERDIN	KAMBE	SUBASHAJ	329
360	AGIM	HALIL	SMAKA	222
361	LEONA	PETRIT	SALAJ	406
362	MARIGL	LILI	PIPA	221.9
363	MEHME	NEZET	SALIAJ	300
364	PETRAQ	VASIL	NAKA	331
365	AGRO	FANI	MONE	283
QARKU FIER, ZONA KADASTRALE 3031 ZVRPP FIER				
366	MRESIJ	VELI	HATELLARI	351
367	SHKEN	SHABA	HOXHAJ	170
368	SHKEN	SHABA	HOXHAJ	889
369	FEIM	ISMAIL	BRAHUSHAJ	323
370	YLLI	RUSTEM	CANAJ	498
371	HAMIT	MUHAME	BRAHUSHAJ	308
372	SKENDE	XHEPO	BRAHUSHAJ	407
373	RAMIS	SKENDE	BRAHUSHAJ	448
374	THANAS	QEMAL	XHOKAXHI	411
QARKU FIER, ZONA KADASTRALE 1634 fshati Frakull e				
DREJTORIA E ALIUZNI-I DURRES				
QARKU DURRES, ZONA KADASTRALE 1925, ZVRPP				
376	SAJMIR	JUSUF	FARRICI	400
QARKU DURRES, ZONA KADASTRALE 3385, ZVRPP				
377	MARIGLE	GEZIM	JAHOLLARI	200
	GEZIM	HYSEN	JAHOLLARI	
QARKU DURRES, ZONA KADASTRALE 3542, ZVRPP				
378	NARDI	ZINI	HOXHA	90
	FIKE	BAJRAM	HOXHA	
379	NARDI	ZINI	HOXHA	71
	FIKE	BAJRAM	HOXHA	
QARKU DURRES, ZONA KADASTRALE 8518, ZVRPP				
380	JOLLAND	SOTIR	SHAHAJ	19
QARKU DURRES, ZONA KADASTRALE 8516, ZVRPP				
381	JANI	ANDON	COMOLLARI	138

382	LEFTER	ANDON	COMOLLARI	137
383	BUJAR	QEMAL	PAPUSHALLAI	456
384	SHPRE	HAXHI	TURKU	391
QARKU DURRES, ZONA KADASTRALE 8514, ZVRPP				
385	HATE	XHEMAL	BERHOMI	17
	MERIT	ABDYL	BERHOMI	
QARKU DURRES, ZONA KADASTRALE 8511, ZVRPP				
386	RITVA	AGRON	GJEVORI	410
	MIRJET	AVDYL	GJEVORI	
387	BAJRAM	HASAN	DUNGA	522
DREJTORIA E ALIUZNI-I TIRANA RURALE				
QARKU TIRANE ZONA KADASTRALE 2380, ZVRPP TIRAN				
QARKU TIRANE ZONA KADASTRALE 3550, ZVRPP TIRAN				
QARKU TIRANE ZONA KADASTRALE 1604, ZVRPP TIRAN				
388	ARJAN	FERIK	ÇULLHAJ	223.5
389	HAXHI	ALUSH	RRAHMANI	262.2
390	HAMDI	MUSTA F	TOSHI	316.8
QARKU TIRANE ZONA KADASTRALE 1605, ZVRPP TIRAN				
391	BAJRAM	MEDI	BASHA	356.4
ASLLAN DEMUSH				
398	SADRI	HYS	DARSI	350
QARKU TIRANE ZONA KADASTRALE 1604				
399	ISLAM	BAJRA	AHMETI	293.7
QARKU TIRANE ZONA KADASTRALE 2105				
400	MENTO	RAMAD	SHIRA	350.4
QARKU TIRANE ZONA KADASTRALE 3064				
401	RIDVA	KAMBE	MLLOSHI	262.2
QARKU TIRANE ZONA KADASTRALE 2951				
402	ASTRI	MERSI	CELMETA	370
QARKU TIRANE ZONA KADASTRALE 2953				
403	ARBEN	FETAH	METKO	421.5
404	KUJTIM	TERXHA	LENA	492.9
405	AGRON	KUJTIM	LENA	419.4
406	SULEJMA	DEMIR	KALAJA	419.4
QARKU TIRANE ZONA KADASTRALE 3866				
407	RIZA	SERVET	XHEPA	264.3
408	SERVET	TAHIR	XHEPA	297
	ARTAN	SERVET	XHEPA	
409	MUNIR	ISUF	PUCI	266.1
409	SADIK	HAJREDI	CERA	234.9
410	ZAMBAK	CAUSH	DINOSHI	159.3
411	HAJREDI	QERIM	ISTREFI	198.8
412	FERIT	MAN	CERA	500
413	LIRI	NUREDI	BARDHI	110.8
414	ERVIS	QEMAL	SHABANAJ	288.6
415	FATIME	SEID	SALLAKU	261
416	DRITAN	HASAN	STAJA	288
417	SKENDE	HALIL	ALMADHI	419.4
418	BEQIR	HAMID	MANSAKU	309.4
419	HIKE	SALI	HAROKU	246.3
420	SANIJE	JONUZ	LEKA	294.3
	DYLBIN	NEBI	LEKA	
421	KASAM	DAN	DANI	500
422	NDUE	ZEF	DODA	289.5
423	IMERLI	SADIK	ÇUNI	240.9
424	HIQME	ALI	ALIA	275.1
425	SADRI	RIZA	FERATI	312.3
426	MEXHI	MUSTA	LOSHA	248.4
427	NIKOLL	GJIN	KADRIJA	308.4
428	GANI	ASLLA	BRATA	351
429	FATJON	KADRI	XHIXHA	226.8
430	BALI	HALIL	JAHELEZI	273.3
431	GZIM	GJON	NIMANI	295.5

Prodhuesit e energjisë nga fotovolatikët

Balluku: Po punojmë për metodologjinë

Mungesa e akteve nënligjore që do të zgjidhte problematiken e tepricave të energjisë në rrjet, nga prodhuesit që kanë instaluar impiante fotovolatike për vetëkonsum, ka bërë që ky grup të ngrëjë herë pas here shqetësimin pranë institucioneve. Këtë të enjte ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Belinda Balluku, i është përgjigjur interpellancës së thirrur nga përfaqësuesit e bizneseve që kanë instaluar fotovoltaike për vetkonsum, kërkuar përmes Platformës së Bashkëqeverisjes. Tema e in-

terpellancës ishte pikërisht nxjerrja e akteve nënligjore për miratimin e procedurës së lehtësuar për lidhjen në sistemin e shpërndarjes të projekteve të vogla të energjisë së rinovueshme. Balluku i siguroi përfaqësuesit e grupit të interesit se ministria që drejton e njëjshet shqetësimin e tyre, teksa bëri të ditur se pas tryezës së zhvilluar pak ditë më parë në MIE, është duke u punuar mbi procesin dhe kryesisht mbi metodologjinë, e

cila ka qenë e munguar. "Ne e njohim shqetësimin tuaj dhe për këtë arsye kemi nisur një proces i cili ka disa javë, ashtu siç kemi deklaruar edhe në tryezën e ekspertëve që është bërë në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë. Jemi duke punuar me këtë proces dhe kryesisht mbi metodologjinë e cila ka qenë e munguar", tha Balluku. Duke ju drejtuar prodhuesve të energjisë fotovoltaike për vetkonsum, ministria rendi

ti një sërë problematikash që duhen zgjidhur për ta bërë funksionale marrëdhënien e tyre me Operatorin e Shpërndarjes së Energjisë Elektrike. Për t'i dhënë zgjidhje këtij shqetësimi, ministria Balluku kërkoi ngritjen e një grupi të përbashkët pune me përfaqësues nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, OSHEE dhe grupet e interesit. Pjesë e interpellancës ishin edhe ekspertët të Ministrisë së Infrastrukturës dhe En-



Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Belinda Balluku

ergjisë si dhe përfaqësues të Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, të cilët ju përgjigjen pyetjeve të adresuara nga prodhuesit e energjisë së rinovueshme si

dhe shpjeguan në detaje problematikat që duhen zgjidhur për të mbërritur më pas te dalja e udhëzimit të ministrit që rregullon ligjërisht këtë proces.

Qeveria, iniciativa për krijimin e një mjedisi më të favorshëm për biznesin

Denaj: Më pak kontrollë fizike dhe dokumentare

Tatimet, një trajtim më të favorshëm për vlerësimin e riskut

Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Anila Denaj drejtoi takimin e parë të Komitetit Kombëtar të Lehtësimit të Tregtisë për vitin 2019 me aktorët institucionale dhe përfaqësuesit e bizneseve ku u diskutua mbi potencialet e lehtësimit të tregtisë për operatorët në vend. Denaj u shpreh se roli i Komitetit për këtë vit është i një rëndësie të veçantë, pasi prej janarit Ministria e Financave dhe Ekonomisë drejton Marrëveshjen për Tregtinë e Lirë në Evropën Qendrore (CEFTA). Ministria Denaj vuri theksin te përfitimet që bizneset kanë nga programi i Operatorëve Ekonomikë të Autorizuar dhe mundësitë që krijohen për aksesin e mëtejshëm të tregjeve rajonale dhe europiane për këto sipërmarrje. "Është një program i menduar mbi të gjitha për biznesin! Për vetë statusin që marrin, operatorët kanë: një trajtim më të favorshëm për vlerësimin dhe kontrollin e riskut; më pak kontrollë fizike dhe dokumentare; njoftim paraprak në rast kontrolli fizik; trajtim prioritar për kontroll, lehtësi në zgjedhjen e vendit të kontrollit; avantazhe logjistike, mundësi të planifikimit të transportit duke minimizuar vonesat dhe reduktuar kostot e më gjerë", tha Denaj. Ndërsa në lidhje me kuadrin e hartimit të një Strategjie Rajonale të Menaxhimit të Riskut janë identifikuar tashmë 12 profile rajonale të riskut me synim pasjen e dokumentit politikash brenda vitit 2019. "Dëshiroj të falënderoj Bankën Botërore dhe t'ju bëj me dije se ajo ka ofruar suportin e saj për dizajnin dhe instalimin e një Arkitekture Teknike dhe Funksionale për Single Window, duke na ndihmuar të kemi modele të procesimit të biznesit dhe pika të përbashkëta dogan-

KOMITETI KOMBËTAR I LEHTËSIMIT TË TREGTISË

Mbledhja e VII-të

Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Anila Dena, në takimin e Komitetit Kombëtar të Lehtësimit të Tregtisë

DOGANAT, SI MERRET STATUSI AEO-ve

Belinda Ikonimi, drejtoresha e Përgjithshme e Doganave, informoi përfaqësuesit e biznesit mbi procesin e përfitimt të statusit të Operatorit Ekonomik të Autorizuar, AEO. Sipas saj, deri tani kanë aplikuar dy biznese për të marrë statusin e AEO-ve, ndërkohë që statusin e zhdoganuesit lokal e kanë përfutur tashmë nëntë biznese, si një hap paraprak drejt atij të AEO-së. Sipas njoftimit, marrja e këtij statusi do t'u lehtësojë atyre mjaft procedura doganore brenda dhe jashtë vendit, pasi krijon akses të mëtejshëm në tregjet rajonale dhe europiane për këto sipërmarrje.

ore jo vetëm me Kosovën, por edhe me Maqedoninë"-tha ministria. Më tej, Ministria ftoi të gjitha palët në Komitet për një përfshirje më të gjerë dhe një nivel më të lartë bashkëpunimi, në këtë platformë të përbashkët për politikën e zhvillimit të tregtisë.

STRATEGJIA

Për përmirësimin e klimës së biznesit Ministria e Financave dhe Ekonomisë, së bashku me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, janë angazhuar në zbatimin e një hjes reciproke të dokument-

eve kufitare dhe programeve të operatorëve ekonomikë të autorizuar sipas Protokollit Shtesë 5. Gjithashtu Shqipëria do të drejtojë negociatat për Protokollin Shtesë 7 mbi Zgjidhjet e Mosmarrëveshjeve në fushën e Tregtisë në CEFTA, tashmë një domosdoshmëri për rajonin. Qeveria shqiptare i është përkushtuar lehtësimit të tregtisë përmes shkëmbimit të informacionit me autoritetet doganore, element që shkurton procedurat dhe kohën për operatorët në pika

doganore, rrit konkurrueshmërinë e operatorëve shqiptarë dhe sigurisht përmirëson shërbimin e ofruar nga Drejtoria e Doganave. "Në CEFTA, synojmë po ashtu, nisjen dhe nxitjen e mëtejshme të bisedimeve të ndërsjella mes vendeve për çështjet e mbikëqyrjes së tregut dhe ndihmës shtetërore në rajon, e cila shpeshherë është përmendur dhe sjellë në vëmendje nga bizneset shqiptare. Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe unë si Ministre, do të vazhdojmë përpjekjet për promovimin e dialogut publik-privat në CEFTA dhe në vend. Shqetësimet e biznesit duhet të adresohen përmes kanaleve të duhura dhe Qeveria po bën maksimumin për ofrimin e këtyre kanaleve të qëndrueshme dhe të besueshme për biznesin"-th Denaj.

BERZH rrit financimin për Shqipërinë

Spacapan: "Tregu shqiptar i energjisë, potencial të madh"

Qytetarët që jetojnë në ndërtesa private dhe komunitare në Shqipëri do të përfitojnë nga një akses me i gjerë në financim për projekte të ruajtjes energjetike falë Programit të Financimit të Ekonomisë së Gjelbër. GEFF është lançuar së fundmi nga BERZH dhe ka si qëllim të zvogëlojë përdorimin e energjisë në sektorin e banesave, të ulë ndotjen e ajrit dhe të përmirësojë komoditetin e jetesës. "Programi quhet Geff (Green Economy Financing Facility) dhe është një program që promovon eficiencën e energjisë në sektorin e rezidencave dhe shtëpiave. Ne jemi duke bashkëpunuar me institucione financiare lokale të cilat do të shpërndajnë fonde të posaçme për familjet shqiptare me qëllim përmirësimin e eficiencës së energjisë në shtëpitë e tyre. Ky program shtrihet në të gjithë Ballkanin Perëndimor. Aktualisht gjendemi në Bosnjë Hercegovinë, Kosovë, Maqedoni, Serbi, dhe së fundmi në Shqipëri. Programi ka prioritet familjet. Banorët do kenë mundësinë të investojnë në rinovimin e banesave të tyre nëpërmjet sektorëve tipik të teknologjisë, për shembull izolimet shtëpiake, kaldajat, sistemet ngrohëse, panelet diellore, pra të përmirësojnë performancën e pajisjeve të energjisë. Ne program kemi gjithashtu hapësira për huamarrës do tosha, mund të jenë kompani që prodhojnë panele diellore ose merrren me tregtimin, kaldaja, kondicionerë, dhe më saktë me pajisjeve të certifikuara të energjisë. Ne po bashkëpunojmë me dy banka lokale. Kemi një fond prej 9 milionë lekësh në total. Besojmë se këto 9 milion do të shkojnë për të paktën 5 mijë familje. Plani është të punojmë me më shumë banka, për të përfshirë sa më shumë familje, dhe besojmë se ky fond do të rritet akoma më shumë. Për momentin nuk e dimë saktësisht sa, varet nga dhuruesit. Ne do të veprojmë njësoj me bankat e tjera që duan të na bashkohen" u shpreh drejtoresha operacionale e BERZH për Londrën, Veronica Spacapan. "Sipas analizave që kemi bërë vetëm 9% e familjeve të zakonshme kanë implementuar metoda të eficiencës së energjisë. Ne shohim që tregu ka një potencial të madh. Ne kemi nevojë t'i japim një dorë tregut që të zhvillohet në këtë sektor, prandaj kemi nevojë për bashkëpunimin e bankave, për të mobilizuar investimet pasi ky sektor nuk ka akoma vëmendjen e duhur"-pohoi Spacapan lidhur me investimet e bëra në tregun e energjetikës në Shqipëri.



Njoftim për shitje me ankand

Sh "Power & Justice" (P&J) sh.p.k ka shpallur ankandin e tretë të pasurisë të palës debitorë Sh "ARNI" sh.p.k dhe hipotekuesve P Goxhaj dhe M Goxhaj, Pasuria që del në ankand të tretë përbëhet nga:

"Apartament", me Nr pasurie 69/11/ND+1-14 ndodhur ne Rr "Dodona", Hyrja nr.1, Kati 3 Ap 14, Orkum e regjistruar ne ZVRRP- Vlore, Z.K Nr.2932, volumi 16, faqe 120. Ankandi i pasurisë fillon me çmimin fillestar në masën 1.209.600 lekë Ankandi do të zhvillohet në datë 10.04.2019 në orën 15:00 në selinë Bul "Gjergj Fishta" Kulla 1, Kati 2, Zyra nr.5. Kontakt 067 2082543 e-mail ilir_dervishaj@yahoo.com faqen WEB www.powerjustice-all.com.

Krimineli i luftës, drejtues i masakrës së Srebrenicës, ku u vranë 8 mijë veta

U dënua përjetë për krimet në Bosnjë, Karaxhiç: S'jam penduar

"Populli serb dhe unë tashmë kemi fituar"

Gjykata Ndërkombëtare e Hagës dënoi dhe me burgim të përjetshëm, Radovan Karaxhiç, i cili u shpall fajtor për krimet dhe gjenocidin e kryer kundër popullatës civile në Bosnje-Hercegovinë. Pas vendimit, Karaxhiç përmes avokatit të tij ka folur për televizionin publik serb, ndërsa shtoi se nuk është penduar për mijëra vdekje të shkaktuara në Bosnje Hercegovinë dhe konkretisht për masakrën e Srebrenicës, ku mbetën të vrarë mbi 8 mijë burra dhe djem. Ai i tha televizionit serb se viktimat e vërteta kanë qenë qytetarët serbë, të cilët dhanë jetën për Serbi të lirë. "Populli serb dhe unë së bashku me të, tashmë kemi fituar. Republika serbe është krijuar dhe populli serb është i lirë në vendin e tij. Mijëra të rinj serb dhanë jetën e tyre për Republikën e Serbisë. Viktimat më të mëdha ishin ata, që dhanë jetën për lirinë e popullit serb. Këta janë viktimat e vërteta", ka treguar Slladojeviç pas një bisede që ka pasur me Karaxhiçin, gjysmë ore pas vendimit, shkruan B92. Ai



Radovan Karaxhiç

shtoi se ky dënim është një hakmarrje e Tribunalit të Hagës. "Nuk u dorëzuam

as kur ishte shumë më vështirë, kështu që kurrë nuk do të ndalemi të

luftojmë për të vërtetën rreth luftës sonë të drejtë në luftën që na është im-

"Populli serb dhe unë së bashku me të, tashmë kemi fituar. Republika serbe është krijuar dhe populli serb është i lirë në vendin e tij. Mijëra të rinj serbë dhanë jetën e tyre për Republikën e Serbisë. Viktimat më të mëdha ishin ata, që dhanë jetën për lirinë e popullit serb"

ponuar, e në të cilën u vranë njerëz të tri nacionaliteteve. Secila luftë rezul-

ton me krime të cilat shpesh ynë i dënoi dhe i ndoqi. Ne kemi luftuar me ndershmeri për lirinë dhe barazinë e popullit serb në Bosnje e Hercegovinë. Prandaj ne jemi gjithmonë dinjitoz kudo, nuk urrejmë të tjerët, dhe e ruajmë me krenari atë që është mbi ne, Republika Srpskan", ka thënë ndër të tjera, Karaxhiç. Krimineli serb Karaxhiç më herët ishte dënuar me 40 vjet burg, por përkundër apelit, Gjykata e Hagës dhe dha fjalën e fundit duke dënuar atë me burgim të përjetshëm. Si rezultat i agresionit serb dhe gjenocidit të kryer mbi popullatën civile të Bosnjës e Hercegovinës, kanë mbetur të vrarë më shumë se 100 mijë njerëz të pafajshëm.

Presidenti serb: Gjermania e Franca të jenë më insistuese

Marrëveshja me Kosovën, Vuçiç: Vonesa mund t'i vërë flakën rajonit

Vonesat e arritjes së një marrëveshje ndërmjet Kosovës dhe Serbisë mund të destabilizojnë Ballkanin Perëndimor, i cili ende po këndellet nga luftërat e viteve të 90-ta, tha në një intervistë për Reuters, presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiç. "Çdo ditë vonesë mund të krijojë kushte në të cilat një shkëndijë mund ta ndezë në flakë tërë rajonin. Vendet perëndimore duhet ta dinë këtë", tha presidenti serb. Për të rifilluar dialogun, Serbia kërkon nga Prishtina të heqë tarifën ndaj mallrave serbe të vendosur në nëntor të vitit të kaluar si kundërpërgjigje të asaj që Prishtina e quan fushatë të Serbisë për parandalimin e anëtarësimit të Kosovës në organizata ndërkombëtare. Ndërkohë presidenti i Serbisë, Aleksander Vuçiç dhe presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi e kanë përmendur si ide ndryshimin e kufijve si pjesë e një marrëveshjeje të paqes mes dy vendeve. Vuçiç këtë e quan "përcaktim të kufirit", ndërsa Thaçi "korrigjim të kufijve". Mirëpo shumë analistë këtë ide e shohin si një përpjekje shkëm-



Presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiç

Ambasadori



MONDOLONI

Ambasadori francez në Serbi, Frederic Mondoloni ka folur për dialogun mes Kosovës dhe Serbisë. Ai ka thënë se Franca nuk ka vija të kuqe kur bëhet fjalë për zgjidhjen e problemit të Kosovës, që sipas tij nuk do të thotë se do të pranojë çdo zgjidhje. Mondoloni po ashtu tha se i mbetet të dyja palëve të gjejnë një zgjidhje të pranueshme, si dhe shqyrtimin e të gjitha mundësive për të zgjidhur konfliktin me kompromis.

bimesh territoriale. "Pranimi ynë (Serbisë) në Bashkimin Evropian varet nga dialogu me Prishtinën dhe,

nëse një ditë do të arrijmë një marrëveshje", thotë në këtë intervistë për Reuters, presidenti serb Vuçiç duke

DAÇIÇ

Ministri i Jashtëm serb, Ivica Daçiç, në konferencën e OKB-së në Buenos Aires, ka falënderuar vendet që nuk e kanë njohur Kosovën.

Daçiç është shprehur se me mosnjohje të Kosovës këto vende demonstrojnë angazhimin e tyre ndaj parimeve të së drejtës ndërkombëtare, Kartës së Kombeve të Bashkuara dhe Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së.



shtuar se ai pret që Gjermania, Franca apo BE-ja të bëhen më aktive në procesin negociues.

SULMOHEN PESE XHAMI NE ANGLI



FOTO LAJM

Pesë xhami në Birmingham të Anglisë kanë rënë pre e sulmeve gjatë natës dhe në orët e para të mëngjesit të së enjtes. Sipas autoriteteve angleze sulmi ka ndodhur konkretisht në orën 02:00 të natës, ndërsa një rast tjetër i ngjashëm u njoftua 45 minuta më vonë në Erdington. Një zëdhënës i Qendrës Islame tha se kapi dhe identifikoi një njeri, i cili po shkatërronte dritaret e xhamive. "Të gjitha dritaret e para u shkatërruan", tha ai. Zyrtarët nga Njësia Kundër Terrorizmit po hetojnë ngjarjen. Yousef Zaman, kryetar i xhamisë së Masjid Faizul Islam në Aston, pohoi se tashmë pas sulmeve të fundit ndaj xhamive, familjarët nuk po dërgojnë më fëmijët në xhami, sepse kanë frikë për jetën dhe sigurinë e tyre.

Voltiza Duro

Qendra e Shërbimeve Arsimore: Cilat janë 21 profilet ku do të testohen kandidatët

Zbardhen emrat e 180 mësuesve që do të nënshtrihen provimit të shtetit

Kalendari i plotë me datat e testeve në mars-prill

P prej javës së dytë të muajit mars e në vijim të këtij viti, mësuesit po i nënshtrihen provimit të shtetit, i cili zhillohet në ambientet e Qendrës së Shërbimeve Arsimore. "Gazeta Shqiptare" zbardh sot emrat e 180 aplikantëve që do të testohen në profilin Arsim Fillor, Matematikë-Fizikë, Anglisht, Frëngjisht, Gjuhë Shqipe dhe Letërsi, Biologji-Kimi, Kimi, Histori-Gjeografi, Histori, Informatikë, Matematikë-Informatikë dhe Shkenca Sociale si dhe datat përkatëse për secilin. Gjithashtu, gazeta publikon edhe kalendarin e provimeve të shtetit në profesionin e mësuesisë për sezonin mars-prill

2019. Kandidati duhet të paraqitet në QSHA 30 minuta para fillimit të testimit. "Ditën e provimit kandidatët duhet të jetë i pajisur me letërnjoftim (kartë ID ose pasaportë) për pjesëmarrje

në provimin e shtetit (dokumenti original); kopje të kartës ID ose pasaportë; faturën e pagesës së tarifës së provimit të shtetit për llogaritë të QSHA, nga një bankë të nivelit të dytë/postë (sipas

faturës për arkëtim të publikuar në faqen zyrtare të QSHA) sipas herës së pjesëmarrjes; si dhe kopje të diplomave të programeve të ciklit të parë dhe të dytë të studimeve të përfunduara prej

tyre, si dhe njohjen e tyre nga MASR, në rast përfundimi të programeve të studimit jashtë shtetit", - thekson QSHA. Ndërkohë, kandidatët të cilët nuk janë pajisur me diplomë të ciklit të dytë të

studimeve, duhet të paraqesin një vërtetim nga universiteti përkatës, ku konfirmohet shlyerja e të gjitha detyrimeve, përfshirë edhe gjuhën e huaj, sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

EMRAT E 1180 MËSUESËVE QE DO T'I NËNSHTROHEN PROVIMIT TË SHTETIT

Emri	Atësia	Mbiemri	Profili	Orari	Emri	Atësia	Mbiemri	Profili	Orari	Emri	Atësia	Mbiemri	Profili	Orari
Florin	Fetah		Fizikë	25.03.2019 09:00	Armend	Selami	Salkurti	Matematikë Informatikë	26.03.2019 11:30	Blerita	Shaban	Karasaali (Sula)	Matematikë Informatikë	26.03.2019 11:30
Florina	Nikolla (Ballal)		Fizikë	25.03.2019 09:00	Blerita	Nezir	Shahinaj (Shtaror)	Matematikë Informatikë	26.03.2019 11:30	Burbuqe	Avni	Kokomani	Matematikë Informatikë	26.03.2019 11:30
Florjan	Hysen	Lika	Fizikë	25.03.2019 09:00	Dajana	Hasan	Mullall	Matematikë Informatikë	26.03.2019 11:30	Femina	Adur	Verim	Matematikë Informatikë	26.03.2019 11:30
Gentjan	Guri	Skopec	Fizikë	25.03.2019 09:00	Dheshpo	Gjergji	Koraqi	Matematikë Informatikë	26.03.2019 11:30	Elis	Marigjen		Matematikë Informatikë	26.03.2019 11:30
Gjovani	Prend	Lleshi	Fizikë	25.03.2019 09:00	Erjon	Petrit	Gjana	Matematikë Informatikë	26.03.2019 11:30	Ervin	Bakri	Hysa	Matematikë Informatikë	26.03.2019 11:30
Gjysta	Kola	Fikaj	Fizikë	25.03.2019 09:00	Evioia	Ali	Hoxhalli	Matematikë Informatikë	26.03.2019 11:30	Festim	Ibrahim	Dauti	Matematikë Informatikë	26.03.2019 11:30
Hamdie	Shaban	Shpetim	Fizikë	25.03.2019 09:00	Fatos	Azis	Baruti	Matematikë Informatikë	26.03.2019 11:30	Helena	Nazmi	Cikalleshi	Matematikë Informatikë	26.03.2019 11:30
Jonida	Hajdar		Fizikë	25.03.2019 09:00	Femina	Adur	Gueci	Matematikë Informatikë	26.03.2019 11:30	Kristina	Albert	Dervishi	Matematikë Informatikë	26.03.2019 11:30
Lindite	Bajraktari		Fizikë	25.03.2019 09:00	Luiz	Malvina	Qirjako	Matematikë Informatikë	26.03.2019 11:30	Kristina	Viktor	Bakalli	Matematikë Informatikë	26.03.2019 11:30
Lumturije	Iskenderi (Mustafa)		Fizikë	25.03.2019 09:00	Luiz	Malvina	Qirjako	Matematikë Informatikë	26.03.2019 11:30	Luiz	Malvina	Qirjako	Matematikë Informatikë	26.03.2019 11:30
Shqipe	Muja (Hajdari)		Fizikë	25.03.2019 09:00	Malvina	Meriman	Muharrem	Matematikë Informatikë	26.03.2019 11:30	Luiz	Malvina	Qirjako	Matematikë Informatikë	26.03.2019 11:30
Valbona	Lleshi		Fizikë	25.03.2019 09:00	Meriman	Muharrem	Muharrem	Matematikë Informatikë	26.03.2019 11:30	Malvina	Meriman	Muharrem	Matematikë Informatikë	26.03.2019 11:30
Vitorie	Nazif	Harizi (Tresa)	Fizikë	25.03.2019 09:00	Muriz	Ali	Begaj	Matematikë Informatikë	26.03.2019 11:30	Meriman	Muharrem	Muharrem	Matematikë Informatikë	26.03.2019 11:30
Demokrat	Ruzhdi		Fizikë	25.03.2019 09:00	Nazif	Hoxha	Qendro	Matematikë Informatikë	26.03.2019 11:30	Muriz	Ali	Begaj	Matematikë Informatikë	26.03.2019 11:30
Adelina	Lazer		Matematikë Fizikë	25.03.2019 11:30	Bica	Buzani (Lleshi)	Bejto	Matematikë Informatikë	26.03.2019 11:30	Ylli	Stefan	Stefan	Matematikë Informatikë	26.03.2019 11:30
Amarilda	Ahmet	Boshnjaku (Mëllugja)	Matematikë Fizikë	25.03.2019 11:30	Sali	Merkaç	Fatmir	Informatikë	26.03.2019 14:00	Albina	Albion	Brahim	Informatikë	26.03.2019 14:00
Arjeta	Ahmet	Boshnjaku (Mëllugja)	Matematikë Fizikë	25.03.2019 11:30	Nazif	Lala	Isufaj	Informatikë	26.03.2019 14:00	Albion	Brahim	Brahim	Informatikë	26.03.2019 14:00
Arsena	Agron		Matematikë Fizikë	25.03.2019 11:30	Edir	Reme	Onuzi	Informatikë	26.03.2019 14:00	Brahim	Brahim	Brahim	Informatikë	26.03.2019 14:00
Barthele	Giaci		Matematikë Fizikë	25.03.2019 11:30	Edir	Reme	Onuzi	Informatikë	26.03.2019 14:00	Brahim	Brahim	Brahim	Informatikë	26.03.2019 14:00
Belisa	Prend		Matematikë Fizikë	25.03.2019 11:30	Enkele	Vetilla (Haka)	Lataj	Informatikë	26.03.2019 14:00	Brahim	Brahim	Brahim	Informatikë	26.03.2019 14:00
Bujar	Urruç		Matematikë Fizikë	25.03.2019 11:30	Enkele	Vetilla (Haka)	Lataj	Informatikë	26.03.2019 14:00	Brahim	Brahim	Brahim	Informatikë	26.03.2019 14:00
Blerina	Ruzhdi		Matematikë Fizikë	25.03.2019 11:30	Enkele	Vetilla (Haka)	Lataj	Informatikë	26.03.2019 14:00	Brahim	Brahim	Brahim	Informatikë	26.03.2019 14:00
Blerita	Ali		Matematikë Fizikë	25.03.2019 11:30	Enkele	Vetilla (Haka)	Lataj	Informatikë	26.03.2019 14:00	Brahim	Brahim	Brahim	Informatikë	26.03.2019 14:00
Demokrat	Ruzhdi		Matematikë Fizikë	25.03.2019 11:30	Enkele	Vetilla (Haka)	Lataj	Informatikë	26.03.2019 14:00	Brahim	Brahim	Brahim	Informatikë	26.03.2019 14:00
Dritan	Xhevit		Matematikë Fizikë	25.03.2019 11:30	Enkele	Vetilla (Haka)	Lataj	Informatikë	26.03.2019 14:00	Brahim	Brahim	Brahim	Informatikë	26.03.2019 14:00
Dhurata	Sali		Matematikë Fizikë	25.03.2019 11:30	Enkele	Vetilla (Haka)	Lataj	Informatikë	26.03.2019 14:00	Brahim	Brahim	Brahim	Informatikë	26.03.2019 14:00
Dhurata	Nazif		Matematikë Fizikë	25.03.2019 11:30	Enkele	Vetilla (Haka)	Lataj	Informatikë	26.03.2019 14:00	Brahim	Brahim	Brahim	Informatikë	26.03.2019 14:00
Edir	Reme		Matematikë Fizikë	25.03.2019 11:30	Enkele	Vetilla (Haka)	Lataj	Informatikë	26.03.2019 14:00	Brahim	Brahim	Brahim	Informatikë	26.03.2019 14:00
Enkele	Vetilla (Haka)		Matematikë Fizikë	25.03.2019 11:30	Enkele	Vetilla (Haka)	Lataj	Informatikë	26.03.2019 14:00	Brahim	Brahim	Brahim	Informatikë	26.03.2019 14:00
Enkele	Vetilla (Haka)		Matematikë Fizikë	25.03.2019 11:30	Enkele	Vetilla (Haka)	Lataj	Informatikë	26.03.2019 14:00	Brahim	Brahim	Brahim	Informatikë	26.03.2019 14:00
Enkele	Vetilla (Haka)		Matematikë Fizikë	25.03.2019 11:30	Enkele	Vetilla (Haka)	Lataj	Informatikë	26.03.2019 14:00	Brahim	Brahim	Brahim	Informatikë	26.03.2019 14:00
Enkele	Vetilla (Haka)		Matematikë Fizikë	25.03.2019 11:30	Enkele	Vetilla (Haka)	Lataj	Informatikë	26.03.2019 14:00	Brahim	Brahim	Brahim	Informatikë	26.03.2019 14:00
Enkele	Vetilla (Haka)		Matematikë Fizikë	25.03.2019 11:30	Enkele	Vetilla (Haka)	Lataj	Informatikë	26.03.2019 14:00	Brahim	Brahim	Brahim	Informatikë	26.03.2019 14:00
Enkele	Vetilla (Haka)		Matematikë Fizikë	25.03.2019 11:30	Enkele	Vetilla (Haka)	Lataj	Informatikë	26.03.2019 14:00	Brahim	Brahim	Brahim	Informatikë	26.03.2019 14:00
Enkele	Vetilla (Haka)		Matematikë Fizikë	25.03.2019 11:30	Enkele	Vetilla (Haka)	Lataj	Informatikë	26.03.2019 14:00	Brahim	Brahim	Brahim	Informatikë	26.03.2019 14:00
Enkele	Vetilla (Haka)		Matematikë Fizikë	25.03.2019 11:30	Enkele	Vetilla (Haka)	Lataj	Informatikë	26.03.2019 14:00	Brahim	Brahim	Brahim	Informatikë	26.03.2019 14:00
Enkele	Vetilla (Haka)		Matematikë Fizikë	25.03.2019 11:30	Enkele	Vetilla (Haka)	Lataj	Informatikë	26.03.2019 14:00	Brahim	Brahim	Brahim	Informatikë	26.03.2019 14:00
Enkele	Vetilla (Haka)		Matematikë Fizikë	25.03.2019 11:30	Enkele	Vetilla (Haka)	Lataj	Informatikë	26.03.2019 14:00	Brahim	Brahim	Brahim	Informatikë	26.03.2019 14:00
Enkele	Vetilla (Haka)		Matematikë Fizikë	25.03.2019 11:30	Enkele	Vetilla (Haka)	Lataj	Informatikë	26.03.2019 14:00	Brahim	Brahim	Brahim	Informatikë	26.03.2019 14:00
Enkele	Vetilla (Haka)		Matematikë Fizikë	25.03.2019 11:30	Enkele	Vetilla (Haka)	Lataj	Informatikë	26.03.2019 14:00	Brahim	Brahim	Brahim	Informatikë	26.03.2019 14:00
Enkele	Vetilla (Haka)		Matematikë Fizikë	25.03.2019 11:30	Enkele	Vetilla (Haka)	Lataj	Informatikë	26.03.2019 14:00	Brahim	Brahim	Brahim	Informatikë	26.03.2019 14:00
Enkele	Vetilla (Haka)		Matematikë Fizikë	25.03.2019 11:30	Enkele	Vetilla (Haka)	Lataj	Informatikë	26.03.2019 14:00	Brahim	Brahim	Brahim	Informatikë	26.03.2019 14:00
Enkele	Vetilla (Haka)		Matematikë Fizikë	25.03.2019 11:30	Enkele	Vetilla (Haka)	Lataj	Informatikë	26.03.2019 14:00	Brahim	Brahim	Brahim	Informatikë	26.03.2019 14:00
Enkele	Vetilla (Haka)		Matematikë Fizikë	25.03.2019 11:30	Enkele	Vetilla (Haka)	Lataj	Informatikë	26.03.2019 14:00	Brahim	Brahim	Brahim	Informatikë	26.03.2019 14:00
Enkele	Vetilla (Haka)		Matematikë Fizikë	25.03.2019 11:30	Enkele	Vetilla (Haka)	Lataj	Informatikë	26.03.2019 14:00	Brahim	Brahim	Brahim	Informatikë	26.03.2019 14:00
Enkele	Vetilla (Haka)		Matematikë Fizikë	25.03.2019 11:30	Enkele	Vetilla (Haka)	Lataj	Informatikë	26.03.2019 14:00	Brahim	Brahim	Brahim	Informatikë	26.03.2019 14:00
Enkele	Vetilla (Haka)		Matematikë Fizikë	25.03.2019 11:30	Enkele	Vetilla (Haka)	Lataj	Informatikë	26.03.2019 14:00	Brahim	Brahim	Brahim	Informatikë	26.03.2019 14:00
Enkele	Vetilla (Haka)		Matematikë Fizikë	25.03.2019 11:30	Enkele	Vetilla (Haka)	Lataj	Informatikë	26.03.2019 14:00	Brahim	Brahim	Brahim	Informatikë	26.03.2019 14:00
Enkele	Vetilla (Haka)		Matematikë Fizikë	25.03.2019 11:30	Enkele	Vetilla (Haka)	Lataj	Informatikë	26.03.2019 14:00	Brahim	Brahim	Brahim	Informatikë	26.03.2019 14:00
Enkele	Vetilla (Haka)		Matematikë Fizikë	25.03.2019 11:30	Enkele	Vetilla (Haka)	Lataj	Informatikë	26.03.2019 14:00	Brahim	Brahim	Brahim	Informatikë	26.03.2019 14:00
Enkele	Vetilla (Haka)		Matematikë Fizikë	25.03.2019 11:30	Enkele	Vetilla (Haka)	Lataj	Informatikë	26.03.2019 14:00	Brahim	Brahim	Brahim	Informatikë	26.03.2019 14:00
Enkele	Vetilla (Haka)		Matematikë Fizikë	25.03.2019 11:30	Enkele	Vetilla (Haka)	Lataj	Informatikë	26.03.2019 14:00	Brahim	Brahim	Brahim	Informatikë	26.03.2019 14:00
Enkele	Vetilla (Haka)		Matematikë Fizikë	25.03.2019 11:30	Enkele	Vetilla (Haka)	Lataj	Informatikë	26.03.2019 14:00	Brahim	Brahim	Brahim	Informatikë	26.03.2019 14:00
Enkele	Vetilla (Haka)		Matematikë Fizikë	25.03.2019 11:30	Enkele	Vetilla (Haka)	Lataj	Informatikë	26.03.2019 14:00	Brahim	Brahim	Brahim	Informatikë	26.03.2019 14:00
Enkele	Vetilla (Haka)		Matematikë Fizikë	25.03.2019 11:30	Enkele	Vetilla (Haka)	Lataj	Informatikë	26.03.2019 14:00	Brahim	Brahim	Brahim	Informatikë	26.03.2019 14:00
Enkele	Vetilla (Haka)		Matematikë Fizikë	25.03.2019 11:30	Enkele	Vetilla (Haka)	Lataj	Informatikë	26.03.2019 14:00	Brahim	Brahim	Brahim	Informatikë	26.03.2019 14:00
Enkele	Vetilla (Haka)		Matematikë Fizikë	25.03.2019 11:30	Enkele	Vetilla (Haka)	Lataj	Informatikë	26.03.2019 14:00	Brahim	Brahim	Brahim	Informatikë	26.03.2019 14:00
Enkele	Vetilla (Haka)		Matematikë Fizikë	25.03.2019 11:30	Enkele	Vetilla (Haka)	Lataj	Informatikë	26.03.2019 14:00	Brahim	Brahim	Brahim	Informatikë	26.03.2019 14:00
Enkele	Vetilla (Haka)		Matematikë Fizikë	25.03.2019 11:30	Enkele	Vetilla (Haka)	Lataj	Informatikë	26.03.2019 14:00	Brahim	Brahim	Brahim	Informatikë	26.03.2019 14:00
Enkele	Vetilla (Haka)		Matematikë Fizikë	25.03.2019 11:30	Enkele	Vetilla (Haka)	Lataj	Informatikë	26.03.2019 14:00	Brahim	Brahim	Brahim	Informatikë	26.03.2019 14:00
Enkele	Vetilla (Haka)		Matematikë Fizikë	25.03.2019 11:30	Enkele	Vetilla (Haka)	Lataj	Informatikë	26.03.2019 14:00	Brahim	Brahim	Brahim	Informatikë	26.03.2019 14:00
Enkele	Vetilla (Haka)		Matematikë Fizikë	25.03.2019 11:30										

Rrëfihet aktori: Skenat me veshje lufte, paruke dhe armë mezi realizohen

Goni Sago:

Më krahasojnë me Ertugrulin, ja e veçanta e personazhit tim te "Black Paradise"

"Korrektesia dhe serioziteti janë formula e suksesit që ndjek në biznes"

Egla Xhemali

A i njihet më së shumti sibiznesmen, megjithatë kohët e fundit e ka marrë seriozisht debutimin si aktor. Një rol i përmbyllur me sukses te "Dashuria s'mjafton", ku ishte nën petkun e një personazhi që vriste dhe grabiste njëkohësisht. Gjithçka ka ardhur spontanisht për Goni Sagon, të cilin së fundmi i është ofruar të bëhet pjesë e një filmi që mezi po pritet. "Black Paradise" nën regjinë e regjisorit të njohur të Hollywood-it Randall Paul i ka besuar Sagos një rol mjaft të rëndësishëm në këtë projekt gjigant. Për "Gazeta shqiptare" aktori tregon për projektin e ri, për skenat më të vështira që i është dashur të realizoj, batutat, momentet kur njerëzit e ngatërrojnë me aktor të huaj dhe këngëtarë dhe të fshehtat e djalit përtej aktrimit. Për familjen Sago nuk do kursente kurrë. Ndër të tjera ai na tregon se si i ka ndihmuar njerëzit është zhgënjyer prej tyre megjithatë veprat e mira thotë aktori i sheh Zoti.

Si erdhi filmi tek ty?
Ka ardhur spontanisht gjithçka. Migtë e përbashkët na njohën, kështu u bëmë miq të mirë me Drilonin dhe duke më njohur tha se kishte një personazh që do të më shkonte. E provuam, dukej mirë, kështu që pranova. Personazhi që ke pasur tek "Dashuria s'mjafton" ka qenë grabitës dhe vrasës.

Sa impenjim donin këto skena?

Impenjim maksimal, sepse kur nuk je i tillë në jetë, e ke të vështirë të futesh në karakter. Megjithatë puna intensive t'i thjeshtëson gjërat. Them se kam arritur ta realizoj më së miri karakterin. Në këto raste patjetër duhen dëgjuar dhe satisfaksionet që ka



marrë publiku.

Tanimë vjen me një rol të rëndësishëm tek "Black Paradise". Si ndihesh që të është besuar?

Fillimisht i surprizuar. Tani ndihem i kënaqur dhe i arrirë disi me veten. Fakti që mu besua do të thotë se kanë parë diçka të veçantë tek unë, ndaj më kanë bërë pjesë. Unë

do bëj më të mirën time për rolin që më është besuar.

Mund të na zbulosh diçka më shumë rreth këtij roli?

Roli është i veçantë, ndryshe nga roli tek "Dashuria s'mjafton". Është një rol pak më me peshë madje më kanë krahasuar edhe me personazhin e "Ertugrul". Tani pady-

shim do kemi edhe me shumë shikues të interesuar për filmin. (qesh)

Skena që mezi e ke realizuar?

Mund të them që janë skenat me veshje lufte, paruke dhe me armë. Janë goxha të vështira për t'u realizuar dhe për t'u dukur sa më reale. Përtej shkëlqimit në



ekran gjatë xhirimeve ka shumë punë. Gjithsesi rezultatet e mira arrihen vetëm përmes përkushtimit dhe punës në grup.

Kur xhirohet një film, si arrini t'i kapërceni batutat mes aktorëve?

Skenari na ndihmon shumë. Pastaj edhe provat, dublat janë një ndihmë e mad-

he për të ndërtuar një dialog sa më praktik. Situata humorit natyrisht që ka. I kapërcëjmë duke u treguar seriozë. Përtej aktrimit je dhe biznesmen i suksesshëm.

Cfarë formule ke ndjekur për të realizuar objektivat e tua?

Korrektesia dhe serioziteti janë një formulë e suksesshme për të shkëlqyer, jo vetëm në biznes. Nuk ngelet pas edhe komunikimi. Gjithçka rrotullohet tek oratoria. Nëse je i zoti me fjalët, atëherë ke realizuar gjysmën e punës. Aftësia e të komunikuarit mirë nuk të lë kurrë në baltë.

Momenti kur të ngatërrojnë me ndonjë aktor të huaj. Si reason?

Qesh. Më ndodh shpesh të më ngatërrojnë edhe me aktorë edhe me këngëtarë. Unë qesh dhe ju them se nuk jam unë.

Për çfarë nuk do kurseje kurrë?

Për familjen, natyrisht. Për ata nuk do të kurseja kurrë dhe nuk do të diskutoja asgjë. As për veten në fakt. Një jetë kemi, asgjë nuk do të marrim me vete.

Cjësja më e çmendur që ke bërë për të cilën nuk do pendohesh?

Kam dhënë dhe bërë shumë për të tjerët, deri aty sa kam shkuar në ekstrem. Jam zhgënjyer, ama jo penduar, sepse po nuk ta diti njeriu, ta di Zoti.



I la të gjithë pa frymë! Kejvina postoi foton që ndezi rrjetin

Ajo është një nga vajzat më të komentuar të momentit. Kejvina u largu nga emisioni 'Xing' për t'i dhënë vetes një mundësi më të mirë në Itali. Modelja ia në mes angazhimit me emisionin në Ermal Mamaqit, për të cilin ai u shpreh me humor se duhet ta gjobiste. Bukuroshja, ndërkohë po vazhdon të pozojë si modele dhe nga ato më provokueset. Këtë herë ajo ka pozuar me pamjen e saj të ëmbël, por pa anashkaluar ekspozimin e gjoksit bombastik. Një aset ky, për të cilin bukuroshja gjithmonë është komentuar pasi e ekspozon me 'krenari'. Brenda pak minutash ajo ia ka dalë të marrë një numër të konsiderueshëm pëlqimesh dhe komente që e duartrokasin për pamjen e saj.



S'e keni parë kurrë kështu! Genta, një "zjarr" i vërtetë në videoklipin e fundit

Ajo ka një energji të jashtëzakonshme për të elektrizuar publikun. Besojmë se e kuptuat që bëhet fjalë për Genta Ismajlin. Këngëtarja po bën gati videoklipin e saj më të ri. Ajo ka zbuluar disa skena të tij, në të cilat shfaqet mjaft provokuese. Titulli i këngës është 'Zjarr', e që natyrisht i shkon shumë edhe asaj vet duke qenë se është uragan në skenë. Së fundmi, Genta ka postuar në Instagram një foto, ku shihet duke vallëzuar mbi një tavolinë ndërsa poshtë e rrethojnë violinat. Kënga me siguri do të jetë ritmike ndërsa Genta nuk ka zbuluar ndonjë datë të publikimit të saj.



"I nxirrni fëmijët për 'like', t'ju vijë turp!" Përgjigjja e Alketës do ju habitë

Xheision Bafti është kthyer në vogëlushin më të dashur për publikun, duke marrë pseudonimin "Taramelja" për shkak të mos shqiptimit të shkronjës "K", gjë që e ka bërë edhe më të ëmbël komunikimin e tij. Alketa Vejsiu ka postuar një video nga puntata më e fundit e "Piter Pan" ku shfaqet Xheision dhe në përshkrimin e videos shkruan se vogëlushi ka arritur plot 60 mijë ndjekës në 'Instagram'. "E di që keni merak ta dëgjoni pak Xheision (vajti 60 mijë ndjekës). Ka Vip-a që kanë punuar gjithë jetën, por 60 mijë zemra në 4 javë s'kanë mundur t'i pushtojnë dot", shkruan Alketa. Mes komenteve të shumta ka rënë në sy ai i një ndjekësi i cili i shkruan Alketës: "I nxirrni këto fëmijë vetëm për like, turp t'ju vijë". "I nxjerrim, sepse Xheisionit kam vendosur t'i rregulloj jetën. Dhe do ta bëj! Kuptove o Tote e mençur?", i përgjigjet Alketa.



Ermal Mamaqi festoi ditëlindjen, ja urimi i veçantë i Amit

Ami dhe Ermali janë ndër çiftet më të pëlqyer për publikun shqiptarë. Jo rrallë herë ata i kanë treguar njëri-tjetrit se duhen fort e sidomos në ditë të veçanta si e djeshmja. Ermali festonte ditën e lindjes dhe ka marrë urimin më të bukur nga partnerja e tij. As këtë vit nuk mund të mungonin fjalët e zemrës dhe urimi emocionues nga ana e Amit për Ermalin. Ajo i shkruan: "Çdo vit që ikën më shumë të dua Erma! Sa shumë gjëra kemi ndërtuar dhe kaluar bashkë dhe sa të tjera na presin."



INTERVISTA

"Nuk mendoj se ka gjë më fantastike se realiteti, siç ka thënë Dostojevski. Pavarësisht kreativitetit, asgjë nuk prodhon dramë më të madhe se vetë realiteti".

SOKOL BEQIRI:

Njeriu nuk shërohet nga lufta, arti s'ka asgjë ideale

Fatmira Nikolli

Një intervistë mbi artin që u shpreh dhe artin që e la: Nuk mund ta ndryshojmë botën

Çelet sot në GKA ekspozita "As mik, as armik", kuruar nga Galit Eilat

Tri makina të mëdha kanë zënë vend në oborrin para hyrjes. Forca të shumta polico-re të veshura me uniformë janë në këmbë. Grumbuj syresh janë ulur diku në bordura. Disa janë të armatosur dukshëm e të tjerëve nuk u dukën armët.

E megjithatë, jemi para Galerisë Kombëtare këtë mes-dreke. Brenda, sot çelet një ekspozitë që kujton 20-vjetorin e ndërhyrjes së NATO-s në Kosovë, ndër-sa jashtë komisaritetit e zbarkuara para institucionit veçse të krijojnë një ide të mjet-ullit amullie.

Ekspozita "As mik, as armik" e artistit nga Peja, Sokol Beqiri, dokumenton me një pamje pothuaj të gjallë tmerret e luftës. Mban mend krismat përtej dritares, erën e tymit, zërat se po zhduken njerëz, pastaj bombat që binin, deportimin e frikën pas tij. Sot para veprave ende përlozet dhe nuk di të thotë se çfarë e trazon shpirtin e tij, kur përballlet me fundin e ekspresionizmit. Por, e di se mali lëviz dhe ra mbi i paprekshmërisë, ka gjetur edhe heroinë e përbotshëm, por kur lufta është larg dhe nuk ka pse të jetë më "Supermen", ai ka humbur besimin në art. "E ndjeja frikën sa isha në studio, e kur dilja prej saj, sillsha si "Supermen", vajzat e mia nuk duhej ta kuptonim frikën time, as atë që ndodhte", rrëfen për një prej videove të tij. Sokol Beqiri e ka braktisur artin në vitin 2006. "Nuk shprehem më. Është një lloj frustrimi i brendshëm. Kam besuar që botën e ndërroj me art. Sot e kuptoj që arti është një veprimtari si të gjitha të tjerat. Më është thyer ideali. Kam kuptuar që arti s'ka asgjë ideale e që artisti është një zanat si gjithë të tjerët". Në një intervistë për "GSH" një ditë para çeljes së ekspozitës, ai tregon edhe raportin e tij me të vërtetën dhe nevojën për të qenë i drejtpërdrejtë. "Në princip me pëlqen ideja e të qenit i drejtpërdrejtë. Me pëlqen të ballafaqohem me realitetin. Nuk mendoj se ka gjë më fantastike se realiteti, siç ka thënë Dostojevski. Pavarësisht kreativitetit, asgjë nuk prodhon dramë më të madhe se vetë realiteti". Beqiri është një nga artistët më të njohur



Sokol Beqiri

bashkëkohorë në Kosovë. Punët e tij më të dalluara janë nga cikllit "Fundit i Ekspresionizmit: e pikturuar nga një i marrë" (2001), cikël i cili përfshin projektet "Milka" (1999) dhe "Kur engjëjt janë vonë" (2001). Ka ekspozuar në shumë institucione evropiane të artit dhe ka qenë pjesë e ekspozitave të rëndësishme, përfshirë "Dokumenta 14" në vitin 2017.

- Gjatë luftës në Kosovë ju ishit në Pejë, i martuar dhe me fëmijë. Shumëçka e ndodhur gjatë luftës u reflektua në veprën tuaj më pas. Si e përjetuat ju luftën? Si ishit ditët tuaja?

Lufta në Kosovë kishte nisur më para se të niste sulmi i NATO-s, por shumë më përpara. Peja si qytet ka qenë një vit më parë në luftë. Ne kemi qenë të izoluar për një vit. Në orën 11-12 paradite, qyteti ishte i mbyllur, prisje çfarë do të ndodhë. Njerëzit filluan të humbasin. Mërnim vesh që "morën atë, morën këtë". Ishte një periudhë e vështirë edhe se zgjati shumë. Një vit intensiv i izolimit.

- Si ishte të jetoje në atë qytet?
Vëreje shumë policë, njerëz të maskuar. E di saktësisht se pas orën 12 të drekës, ne mbylleshim në shtëpi deri në mëngjes. Shihje nga dritarja që luftoje, ndjeje erën e tymit.

- Dhe ndjeje krismat e armëve?

I ndjeje të gjitha dhe ajo ka qenë

për mua periudha më e vështirë.

- Ike gjatë kohës së bombardimeve të NATO-s?

Na deportuan. Ditën e dytë, pasi filluan bombardimet, kanë hyrë shtëpi më shtëpi e na kanë nxjerrë. Dolëm siç ishim. Nuk zgjidhje dot as se ku do të shkoje. Ishin ata që e ndanin turmën, ku do shkonin pjesë të saj. Mua më çuan në Mal të Zi me familjen. Atje na pritën mirë, por kishim frikë se

mund të destabilizohej.

- Si lindi videoja "Supermen"?

Në të gjitha punët e mia, rrallë e kam bërë punën aty për aty. Zakonisht kur e kam menduar një punë, e kam lënë mënjatë për ta menduar gjatë, nëse më pëlqen ajo. Ka pasur momente që s'më ka pëlqyer dhe e kam lënë, e më pas i jam rikthyer.

- Sa takohen mendimet e tua si baba dhe si artist të "Supermeni"?



"Supermen" është xhiruar diku në fillim të vitit 2000. Isha në studio me një artist amerikan, po bënim një bisedë krejt informale dhe ai e xhironi. I tregova për hapësirën në studion time, sa e rëndësishëm ishte e sa kohë shpenzoja aty dhe i tregova edhe një të vërtetë: që një vit para bombardimeve ka qenë i vetmi vend ku kam guxuar të kisha frikë. E ndjeja frikën sa isha në studio, e kur dilja prej saj sillsha si "Supermen", vajzat e mia nuk duhej ta kuptonim frikën time, as atë që ndodhte. Kjo që një bisedë që e bëra me të, krejt natyrshëm pa idenë e një veprë.

- Çfarë moshe kishin vajzat tuaja atë kohë?

10 vjeçe, 6 vjeçe dhe një vjeçe. Ajo ishte historia ime, që ende sot nuk e kam të lehtë ta tregoj.

- Ky është veçse një fragment i luftës së madhe që mandej tregoj përmes luftërave të vogla tuajat personale. Kuratorja Galit Eliat e jo vetëm ajo, ju cilësojnë si një artist shumë të drejtpërdrejtë, sidomos për veprat mbi luftën. A është e vështirë ta tregosh luftën ndryshe?

Jo vetëm mbi luftën, në princip me pëlqen ideja e të qenit i drejtpërdrejtë. Me pëlqen të ballafaqohem me realitetin. Nuk mendoj se ka gjë më fantastike se realiteti, siç ka thënë Dostojevski. Pavarësisht kreativitetit, asgjë nuk prodhon dramë më të madhe se vetë realiteti. I ndikuar edhe nga kjo thënie, kam dashur ta ballafaqoj vizitorin me realitetin. Jo vetëm këto veprat e luftës, sepse këto të luftës, janë të imponuara. Këmbëngul të jem i drejtpërdrejtë dhe i kuptueshëm për çdokënd.

- Kur thoni që veprat e luftës më janë imponuar, nënkuptoni që e kishit të nevojshme të nxirrnit atë që ndjenit, apo donit që bota të dinte se diku, përballë jush, bëhej një luftë?

Atëherë kam besuar se me art e ndryshon botën. Kam ndërjet nevojë ta them atë që ndjeja dhe ishte e vetmja mënyrë me të cilën unë mund të shpreheshja. Unë këtë dija të bëja, e kështu dija ta bëja.

- A e ripërjetoi dhimbjen duke e shprehur atë?

E përjetoi akoma (përlozet). Sidomos ndaj këtyre punëve.



Tre heronj e tre ushtarë

-Ke frikë t'i shohësh?
Jo frikë, nuk di ta artikuloj atë që ndiej. Disa prej këtyre veprave me rikthejnë luftën.

-Një prej veprave më të drejtpërdrejta dhe më të dhimbshme është "Milka" e realizuar më 1999. Krahasohen lopët e prera me viktimat që gjendeshin nga lufta. A ishte kjo ajo që ndjenit ju?

Pak a shumë po. Milka është si një lopë, më e mirë e më e bukur se të tjerat, diku në alpet e Zvicrës, e sigurt, e që sheh me një farë cinizmi diku poshtë në Ballkan, ku ka një kasaphane. Kjo është konceptuar para ndërhyrjes së NATOS dhe ka qenë një farë mënyre, një ironi e cinizmi me mosveprimin e botës. Ideja nisi për të thënë që Milka është një lopë më ndryshe se ne, ma e bukur.

-Pse nuk ike nga Kosova para deportimit? Nuk kishit mundësi a nuk donit?

Mundësinë e kisha. Nuk doja të ikja, kjo është e vërteta. Por tani, them se duhej të kisha ikur.

-Që të mos përjetojta këto?
Po, të mos e përjetojta as unë e as vajzat.

-A je shëruar nga lufta, a mund të shërohesh nga një luftë?

Diçka mbetet patjetër. Mendoj se në një mënyrë a tjetër, diçka nuk ikën kurrë.

-"Fundi i ekspresionizmit" duket se tregon anën më të keqe të njerëzimit. A është vija mes të bukurës e të frikshmes që pothuaj shkrirhet në një?

Ato dy foto kanë një kontekst që dalin nga pamja e parë. Më thirrën që të ndihmoja për të përzgjedhur fotot për një dokumentar për luftën. Po i shihja dhe gjeta dy imazhe (Djali dhe një skenë horror). M'u dukën në pamje të parë si tablo të bukura të ekspresionizmit abstrakt të Alberto Burri-t a Antonio Tapies. Prapavija e tyre më tmerrroi, sepse kuptova që tek njëra (skena horror) ishte një njeri i mbytur dhe i djegur. E mendova se ky ishte fundi i ekspresionizmit, një rrymë që i ka dhënë frymë emocionit dhe ekspresionizmi kishte përfunduar në dhunë. Çdo gjë që ke mësuar në shkollë, mbi ngjyrën, kompozicionin gjendeshin në një foto reale. Nuk mund të flisje me gjuhën e të bukurës, sepse e kishë kuptuar kontekstin. Ndërsa djali, duket si Jezu Krishti, si engjëll. Mirëpo, e ka qafën e thyer dhe është i mbytur në unë. Unë kam dashur që secili të përballlej me to.

-Duke parë këto foto dhe se çfarë ka përjetuar njerëzimi, me të dobëtin që gjithëherë shtypet nga të fortët të ndryshëm, mbase

pa e gjetur kurrë të drejtën që i takon, a duhet të jemi aq pesimistë sa të mendojmë se njerëzimi është i destinuar të vuajë? Mbese, nëse shohim se edhe mbas luftës, shumëçka në Kosovë varet nga reagimi i serb, a merr më shumë sens kjo? Ka njerëz që nuk i dihet varri, gratë e përdhunura gjykohen dhe prapë, Serbia vendos?

Gratë nuk guxojnë të tregojnë çfarë ka ndodhur gjatë luftës. Një grua ka dalë jashtë vendit dhe mbase si ka ikur, ka mundur ta pranojë atë që ka ndodhur dhe të vijë të thotë. Kemi një portret katastrofal të atyre që vuajtën. Gratë, mbase duhet të dalin e të thonë se nuk që fajti i tyre. Ne më shumë preferojmë ta fshehim motrën e dhunuar se ta shërojmë. Por, për sa thoni ju, unë nuk e di, nuk guxoj ta them atë që njerëzimi është i destinuar të vuajë, është më e gjerë. Nuk mund të jap një përgjigje të shpejtë për një vizion mbi njerëzimin e botën. Nuk kam një përgjigje për këtë.

-Në tri foto, tre ushtarë janë vënë përballë tre heronjve. Si takohen ushtarët me heronjtë?

Dikur ata të tre ishin heronj të bashkim vëllazërimit dhe bashkëjetesës mes popujve në Kosovë. Miladin Popovic, Boris Vurmihoviç dhe Ramiz Sadiku. Sadikun bashkë me Vurmihoviçin, i zunë gjermanët gjatë Luftës II Botërore dhe Ramizin donin ta lëshonin se na është thënë se gjermanët nuk kishin gjë me shqiptarët. Ramizi nuk pranoi se s'ka dashur të ndahet nga shoku dhe i kanë pushkatuar të dy. Ne jemi edukuar në shkollë që këta janë heronj se kanë luftuar për të mirën tonë. Tani çfarë ndodh? Këta tre heronj janë simbol i heroizmit

që luftuan Gjermaninë naziste, mirëpo tani, në Kosovë pas 1999-ës, gjermanët u kthyen për ne në heronjtë e rinj. Mbese, gjyshi i tij e ka pushkatuar e sot, ai vjen e mbron bustin e tij nga unë.

-Është një transformim konceptesh, i atyre në të cilat kemi besuar?

Po, sepse janë pyetjet, kush është heroi, çfarë është heroi, çfarë është përmendorja. Evoluimi, prej viktimës del heroi.

-A ishin këta "engjëjt që erdhën vonë"?

Gjermanët këtë herë erdhën si heronj e nuk e di nëse ishin vonë. Ndërsa vepra me këtë titull ka tjetër domethënie. Edhe pse ka dhunë në të, është jashtë luftës. Është një veper e pasluftës, se erdhi një moment që nuk doja më të identifikohesha si një artist që merret me luftën e ka në vepra vetëm gjak e dhunë.

-A është pikërisht kjo ndjenje e juaja, një farë mënyre, jeta e viktimës që nuk është shëruar nga ajo që ka kaluar dhe nuk do të identifikohet më me dhembjen e vet? Ju e gjykoni veten në këtë rast?

Mbase ndonjëherë ende nuk jam i vetëdijshëm në momentin kur flas për këtë djalin apo për "Supermenin". Mendoj se kam për të pasur problem emocionesh dhe përpara çdo bisede për veprat përpigam ta bind veten, përpigam ta kontrolloj veten. Por, nuk mundem, nuk di, diçka ma rikthen atë ndjesi.

-Arrini në këtë ekspozitë edhe të "Shenjat e dashurisë"? Si është ky udhëtim?

Mendoj se është disa logjike mbas luftës të arrish të dashuria. Është një projekt disa më politik.



Jam me familjen, dy prindërit e tri vajzat. U bënë debate për flamurin atë kohë dhe kam bërë këtë veper, sepse flamuri po i trembte njerëzit. Shenjat e dashurinë janë familja ime. Çdo pozicion i një anëtari të familjes është një formë e alfabetit të marinarëve. Janë 7 shkronja e në fund "fuck you".

-Pamë pa gjethe shërbejnë si hyrje e ekspozitës suaj. Çfarë është ky pyll?

Ideja e pemëve, e këtij pylli të shenjtë, nis të Makbethit. Është skena kur i thuhet se asgjë nuk e rrezikon derisa të lëvizë mali. Ai krijoi sigurinë se është i paprekshëm. Teksa armiqët thejnë degët e pemëve në mal, atij i duket si një vizion që mali po lëviz dhe kësh-tu u thye miti i paprekshmërisë. Analogjia mes Makbethit dhe Mil-loshveviçit, është "mali që lëviz", thyerja e mimit të paprekshmërisë. Mali për Kosovën lëviz.

-Para pyllit, është një "Pikachu" mbi strukturën e një heroi popullit. Pikachu, heroi i kujt është, i cili popull?

I të gjithë popujve. Ideja është e heroit universal. Heronjtë tanë, nuk i duan kombet e tjera dhe anasjelltas. Ndërsa Pikachu është një hero universal që lufton të keqen, e që e duan gjithë fëmijët e botës, pavarësisht fesë e origjinës. Kam dashur

një hero që e duan të gjithë dhe ai është një i tillë.

-Në vitin 2006 vendosët të hiqni dorë nga të qenit artist? Si mund të heqë dorë njeriu nga diçka kaq e brendshme, e për ju e vetmja mënyrë për t'u shprehur?

Është një lloj frustrimi i brendshëm. Kam besuar që botën e ndryshoj me art. Sot e kuptoj që arti është një veprimtari si gjithë të tjerat. Më është thyer ideali. Kam kuptuar që arti s'ka asgjë ideale e që artisti është një zanat i zakonshëm. Dallimi është që artisti përdor kor-nizën e telajon. Kjo është një e kaluar e imja që nuk më turpëron.

-Heqja dorë, është si të braktisësh ideat, ëndrrat. Dhe bota ka nevojë për ideale e ëndrra që të ecë përpara. Pse e latë?

Unë nuk shoh më ëndrra. Ky është një zanat dhe kaq. Këto vepra nuk i kam bërë për përfitim, i kam bërë se i kam ndërjet. Se doja të shprehesha. Sot nuk kam më iluzione.

-Si shpreheni sot, nëse braktisur gjuhën tuaj të vetme? Nuk shprehem më.

-Dikur ngujoheshit nga lufta, sot nga vetvetja. Si është të jetosh kështu?

Jo, nuk ngujohem nga vetvetja. Thjesht nuk besoj më në fuqinë e artit për të ndryshuar botën.

DALIN NË DRITË MURET E XHAMISË SË VJETËR TË TABAKËVE NË VLORË

Punimet për rikualifikimin e qendrës historike në Vlorë kanë zbuluar disa mure, të cilat i përkasin një xhamie të vjetër. Punonjësit drejtorisë Rajonale të Kulturës Kombëtare në Vlorë zbuluan pjesë nga muret e lashta teksa pastronin në themelet pranë xhamisë. Kreu i kësaj drejtorie, Orges Feimi, tha dje se po kryhen verifikimet e duhura për objektin e zbuluar, ndërkonjë që punimet janë ndërprerë. Xhamia, e cila daton që prej

shekullit 17, muret e së cilës u zbuluan gjatë punimeve për rikualifikimin e qendrës historike në Vlorë, njihet si Xhamia e Tabakëve, e cila u shemb në 1962. Ajo përmendet si një nga 7 xhamitë kryesore të Vlorës, në vendin e së cilës, pas shembjes, u ndërta qendra e dyqaneve me emrin "Vetëshërbimi". Pas saj gjendet Pazari i Vjetër dhe dyqanet e lëkurëpunuesve të Vlorës. Në shekullin XVII është përmendur nga kronikani i njohur turk, Elvia Celebi. Xhamia e Tabakëve gjendet edhe në materialet historike të viteve 1930



Opinion i Ditës

Përçudnimi i artit, si "performancë"...

Nga Nazif Çela, "Mjeshtër i Madh"

(vijon nga faqja 1)

... ndërtojmë në këto 27 vite të tranzicionit.

Është fakt i pamohueshëm, që në këto vite, ky vend shumë pak (për të mos thënë aspak) prodhoi vepra artistike që mund t'i rezistojnë kohës. Dhe është kaq e vërtetë kjo, sa që kur rrallë e për mall, shteti kujtohet, apo ka nevojën për të realizuar koncerte të rangut shtetëror-koncerte qeveritare, siç quheshin dikur, detyrohet të kërkojë dhe të "gjejë"...

ATA, "TË VJETRIT"...

Nuk prodhoi gjë ky vend, flas në art, në kulturë e në folklor në këto 27 vite, një vepër, që të mbetet në buzët e njerëzve, siç ndodhte dikur.

Prandaj ndodh që kur na vijnë miq të rëndësishëm si nga NATO-ja, BE-ja apo nga diku tjetër (e kur duam të krenohemi), shteti mbledh ata që kanë mbetur gjallë, ata të Kalasë së famshme të Gjirokastrës, që patëm dikur. Por, edhe ata janë rralluar, e shumica e atyre që ende janë gjallë, janë në moshë tejet të thyer, e të pamundur për të "performuar" (na doli dhe ky term këto vite) në skenë.

Ata që bënë eppenë e artit shqiptar ndër vite, në atë kala të shenjtë, në shumicën e tyre, kanë ikur nga jeta.

Në që jetojmë, jemi aq pak, sa që nuk kemi asnjë rol sot, përveç sedit për atë çka u krijua me mund e me djersë, me shumë privacione, halle dhe probleme. Sedit, por edhe shqetësimit që ato arrijtë të paktën të ruhen si gjëra të shenja, e po të ish e mundur, pse jo, të shkojnë edhe më lart.

Sepse më parë se të jenë vlera kulturore të UNESCO-s, ato janë vlera shpirtërore të popullit tonë, vlera për të cilat kanë e do të kenë nevojë brezat. Sepse janë vlera që u ruajtën ndër shekuj, të cilat u hulumtuuan, u gërmuan dhe u përpunuan, duke i ngritur në art, në mënyrën më cilësore të mundshme.

Arti i prodhuar në sheshin e shenjtë të asaj kalaje ishte mekanizmi që bindi botën e qytetëruar përëndimore, që polifoninë ta shpallë "Pasuri të Njerëzimit", e cila ruhet nga UNESCO-ja.

Edhe kjo, e cenuar nga këta "tanët", sepse e sakatuan duke e arkivuar në kërkesën përkatëse, me emrin "isopolifonia"...

Pra, me vullën e shtetit shqiptar të disa viteve më parë, më saktë me firmën e njëfarë ish-drejtoruci në Ministrinë e Kulturës, kërkesa shkoi me emrin e pasaktë - "isopolifonia"...

RREZIKU QË NA VJEN SË BRENDSHMI...

"Ne do bëjmë kujdes t'ju ruajmë nga rrezikët e jashtëm, por nga rrezikët e brendshëm, nuk mundemi t'ju ruajmë dot"...

Këtë fjalë e la të shkruar Mitat Frashëri, të cilën ia pat thënë një



personalitetit të politikës europiane, në vitet '20-të, kur Mitati përpigje të siguronte aleatë mbështetës për shtetin shqiptar të sapolindur...

Për fat të keq, këtë ka vërtetuar historia jonë, të paktën ky shekulli i fundit, ku Shqipëria ekziston edhe si shtet. Aq sa e lanë, e ashtu siç e lanë.

Për fat të keq, nga kjo "ligjësi" kobzëzë, në këto 30 vite të trazuarra nuk ka shpëtuar as arti, më saktë ato çka u arritën në art, në një kohë tjetër.

Në luftën për teleshikueshmëri (audiencë e quajnë sot), disa kanale televizive tonat kanë ngritur e kanë stisur emisione humoristike, të cilat marrin përsipër "t'i ngrenë adrenalinën" popullit, jo rrallë, me qyfyre të rëndomta.

"E drejtë" e tyre do të thosha, ashtu siç është e drejta e teleshikuesve t'i ndjekin këto emisione, apo të ndërrojnë kanal, me pulsin e komandimit.

Pavarësisht vërejtjeve që na bëjnë të huajt, të cilët merren me numërimet e teleshikuesve, sot e 60 vite...

Por në këto emisione "humoristike", humori i të cilave lë shumë për të dëshiruar nëse përjashtojmë banalitetet të rëndomta, jo rrallë është vënë në shenjë për t'u përçudnuar e përdhosur, vetë arti shqiptar.

Shkruesi i këtyre radhëve, nga të tjerë mësoi se në x emision ishte përçudnuar kënga "Janinës ç'i panë sytë", por edhe kënga për këshilltarët e Hekalit...

Miq dhe dashamirës të shumtë të artit telefonuan e vazhdojnë të telefonojnë, duke akuzuar këto përprjekje qëllimëqija për deni-

grimin, përçudnimin dhe diskreditimin e artit, të paktën të këtyre dy këngëve...

Ironia e hidhur e fatit qëndron në faktin se këto përçudnime realizohen "live", para kamerës e nën siglën "Muza". Po fjalën muzë (pa lere nocionin muzë, që nuk e njohin), pse e përqeshin dhe e tallin në atë farë feje?!

Për fjalën Muzë--A--AT, e meqë nuk mbaruam shkollë për Gjuhë-Letërsi, le t'i drejtohem për konsultim Fjalorit të Shqipërisë së Sotme të vitit 1984, botim i Akademisë së Shkencave që patëm... "Muzë: Secila nga të nëntë hyjneshat, bijat e Zeusit, që përkrashin degë të ndryshme të artit e të shkencës (sipas mitologjisë greke) psh. Muza e Historisë (e tragjedisë, e muzikës...) - Fjalori, faqe 749.

Pra, në rastin tonë le të marrim atë "hyjneshën" e muzikës dmth., atë "hyjneshë" që përkrash muzikën.

Për çfarë përkrashjeje të muzikës mund të bëhet fjalë, kur persona që mund të kenë dhunti të veçanta në një drejtim të caktuar, psh. në aktrim, mund të tentojnë të realizojnë edhe "muzën", e që përfundimisht përqeshin, përçudnojnë dhe përdhosin në kuptimin e plotë të fjalës, vepra të artit e të folklorit që u krijuan ndër vite e që u vlerësuan nga bota e qytetëruar?

Nëse bëhet fjalë për emision humorit (që nuk ka përse të ketë humor të zi), atëherë mund të marrë këngë humoristike, të cilat nuk kanë munguar në të gjitha kohërat. Dhe le t'i "performojë" ato. Por jo të përdhosë tekste, këngë dhe interpretime brilante që lanë

vullën e tyre ndër kohëra e që u këndojnë shekujve, për të qëndruar në shekuj.

Dy këngët e mësipërme, të cilat u masakruan dhe u përqeshën keqas në dy emisione me radhë janë këngë që u janë ngritur trimave të rrallë, në çaste kyç të historisë së popullit tonë.

A e dinë "performuesit" kokë-boshë se për tre trimat që u vranë në betejën e "Nëntë Puseve" në Janinë është mbajtur zi kombëtare? Dhe është mbajtur zi e thellë, e cila shkoi në rrenjë të saj pagane; deri edhe zilet dhe këmborët e tufave të bagëtive u hoqën në shenjë zije. Po mirë kjo, se ndodhi "larg" në kohëgati 120 vite më parë (se kujtesa jonë nuk arrin deri aty).

Po këshilltarët e Hekalit, të cilët u mbajtën lidhur nga nazistët dhe ballistët gjashtë ditë rresht edhe pa ujë, para 76 vitesh, çfarë borxhi u patën "performuesve"? Për të shkatërruar pushtetin e popullit, u krijua në Fier Batalioni i Xhandarmarisë Civile, me komandant, majorin Besim Belishova. Në mbështetje të tij u radhitën çetat e Ballit, të Fierit, Lushnjës dhe Mallakastrës.

Gjashtë ditë i mbajtën nën tortura burrat sypatrembur e më 13 dhjetor 1943, i grimë plumbat e togës së pushkatimit. A i njohin këto gjëra "performuesit"?

Kësaj i thonë: - I zoti e shet, e tallalli s'e jep.

Para disa kohësh, "partneri" ynë ballkanik, Serbia, arriti të bëjë pronë të vetën "Ciklin e Kreshnikëve"! Aq sa është shkruasi i këtyre radhëve japonez, po aq edhe "Cikli i Kreshnikëve" është serb. Po si e arritën serbët këtë?

Shumë thjeshtë, se segmente të shtetit tonë, por edhe atij të Kosovës, nuk patën nge të plotësojnë dokumentet për t'ia paraqitur botës si prodhim autentik shpirtëror i këtij kombi, sepse ishin zhytur në gjakun e tenderave dhe në grindjet me njëri-tjetrin. Kurse Serbia e ka shtetin më këmbë, me të gjitha institucionet dhe mekanizmat e tij, me diplomacinë në krye. Ajo nga hiçi stisi dosjen dhe bindi botën se kreshnikët ishin "serbë". Pa nëse ata quheshin Mujë e Halil, këtë le ta hanë shqiptarët, në folklorin e tyre "majekrahu". Bota shkruan dhe vulos, kurse ne çirremi gërxeve dhe shkëmbinjeve dhe dëgjojmë vikamat e njëri-tjetrit.

Është njësoj sikur Greqia të merrte e të shpallte pronë të saj këngën labe e polifoninë, meqenëse disa fshatra të Janinës e të rrethinave të saj këndojnë labçe, thjesht për faktin se janë shqiptarë autoktonë në trojet e tyre mijëvjeçare. Por sot kuptohet, këndojnë në një gjuhë tjetër, në gjuhën e kishës e jo në gjuhën e të parëve të tyre, pra jo shqip.

Në inaugurimin e Sheshit "Skënderbej" erdhën edhe një grup profesorësh francezë, të cilët interpretuan këngën "Janinës ç'i panë sytë". Ishte një nder i madh për vendin tonë në radhë të parë, për artin dhe kulturën tonë. Pse jo, edhe për ne që e interpretuam në Festivalin Këngë të Gjirokastrës, në vitin 1983. Francezët e shquar e interpretuan me dinjitet, një këngë që nuk ishte as në gjuhën e tyre, pa lere më e kombit të tyre. Madje, profesionalisht, ata bënë të pamundurën t'i afroshinin interpretimit të "gjashtë violinave", siç u quajt grupi i Lapardhasës në atë festival, nga të gjitha personalitetet e shquara botërore që ndoqën festivalin.

Edhe pse të huaj, ata nuk e përqeshën këngën, nuk futën tallje dhe ironi "performance", si këta, "artistët tanë".

Shkruesi i këtyre radhëve nuk ka asnjë motiv personal apo profesional në trajtimin e kësaj çështjeje. Ai, si edhe disa të tjerë, është dekoruar me titullin "Mjeshtër i Madh" për ato që ka arritur në interpretimin e këngës. Dhe nuk gëzon, si shumë të tjerë, asnjë lloj mbështetjeje materiale, siç vetë ligji e parashikon. Po se mos përfituan pensionin e parakohshëm që ligji u jep, bardit i këngës Lefter Çipa, poeti i kultivuar e i talentuar, njëri prej më të spikaturëve, Muhamet Tarrari, simaja e tyre Feti Brahimi, të pavdekshmit Gjokë Beci dhe Malik Lila e shumë të tjerë?!

Në këtë kuptim, as kemi prituri e as presim. Por arrijtë tona, që morën vullën e kohës e që u dhanë vullën kohërave nuk mund të lejojmë të përdhosen, e ca më keq, të përdhosen në emër të "të bërit art"...

Opinioni / Ditës

Fatura e pranverës së protestave

Nga Fatos Çoçoli

(vijon nga faqja 1)

... që interesohet vetëm, nga njëra anë të prodhojë spektakël virtual arritjesh reformash, nga ana tjetër pasiguri dhe klimë revolucionari pseudodemokratik, nuk po e kuptojmë çfarë humbjes reale po pësojmë. Deklaratat e disa agjencive turistike që pronotimet e deritanishme për hotelet në bregdetin tonë kanë rënë me 30 përqind këtë vit, në krahasim me gjysmën e parë të marsit 2018, nuk tërhoqën asnjë vëmendje. Nuk prodhuan asnjë shqetësim, kur duhet të ngrihet zëri për humbje të tilla. Muaji mars, së bashku me prillin, janë muajt më intensivë të kontratave të turistëve të huaj. Pronotimet në këta muaj tregojnë edhe mbarëvajtjen e turizmit për një vend gjatë një viti të plotë. Tek ne, rënia me 30 përqind vetëm për gjysmën e parë të marsit mund të përkthehet në 70-80 milionë euro më pak të ardhura për vendin nga turizmi për këtë vit. Dhe pse? Pikërisht për faj të politikës së ditës. Për tensionin e skajshëm dhe pasigurinë që po prodhon ajo. Fatura mund të ngrihet edhe në gjysmë miliardë euro humbje, në rast se do të vijojë kjo pranverë e gjatë protestash. Edhe sikur ato (do Zoti) të mos përfundojnë në ritur e të përshkallëzuar, sërisht pasiguria e kësaj gjendjeje aspak normale të demokracisë në vend, gjithnjë në prag shpërthimi trazirash, do të na largojë nga objektivat më të rëndësishëm për këtë vit e më gjatë. Nga çelja e bisedimeve për anëtarësim në Bashkimin Evropian. Çelje që dukej më afër se kurrë, për shkak të përparimit të reformës në drejtësi. Nga ana tjetër, humbje të forta do të kemi nga mosrritja sa duhet e kredimit për ekonominë. Në nivele që të sjellë mijëra vende të reja pune të hapura për këtë vit. 2019-a dukej një vit i mbarë për huadhënien. Kjo hua-



dhënie, edhe pse e shtuar relativisht pak (5 përqind, duke përfshiruar efektin e heqjes së kredive të këqija nga bilanci dhe bankave) për vitin 2018, paraqitet premtuese për këtë vit. Shpresohet që kredia e rritur të ndizte atë motor zhvillimi që nuk ka punuar kurrë me ritëm të plotë tek ne. Që ka për "karburant" 4 miliardë euro depozita të qytetarëve tanë, që rrinë kot, flenë gjumë nëpër kasaforta bankare. Mirëpo kjo gjasë zhvillimi u zbeh, me daljen e opozitës nga shinat e një jete normale politike. Si qytetarë ende nuk jemi plotësisht të bindur se sa fort ndikon në jetën ekonomike të vendit siguria apo pasiguria politike. Se sa ndikojnë në vendim-marrjen për investime apo në rrezikimin e kapitalit të sipërmarrësve protestat me paralajmërimë ogurzeza për mosbindjen civile. Po ashtu dhe në konsumin e njerëzve. Tani bankat

po bëjnë llogari dhe plane për të mbajtur dorën. Për të mos rrezikuar më shumë se ç'kërkon gjendje aspak normale dhe në pritje trazirash. Kjo është humbja e dytë e madhe që po konturohet për ekonominë tonë këtë pranverë. Ndoshta mund të kemi 300 milionë euro kredi të padhëna, për shkak të klimës politike këtë vit. Dhe me qindra milionë euro investime të huaja të drejtpërdrejta të munguara, po për këtë shkak. Asnjë investues i huaj serioz nuk është aq i krisur sa të aventurohet në tokën tonë që mban me mijëra probleme të tjera të informalitetit, tregut të paqartë të pronësisë për tokën, etj., me një opozitë jashtë parlamentit. Edhe emigrantët tanë do mendojnë dy herë, përpara se të nisnin një sipërmarrje apo investim të menduar gjatë me kursimet e tyre në Itali apo Greqi, apo edhe më larg. Është një dëm kolos-

al kjo tkurrje, kjo stepje gati në bllokim e investimeve dhe e shpirtit sipërmarrës në ekonominë tonë. Një faturre e rëndë, e trishtë dhe e errët. Asnjë politikan i rëndësishëm i ditës nuk duket sot të jetë i vetëdijshëm për këtë dëm që po i bën ekonomisë së shqiptarëve me sjelljen e tij, nga opozita apo pozita qoftë. Asnjë përgjegjës për pasojat që bien gjithnjë mbi ekonominë, sa herë kemi acarime të skajshme të gjendjes politike. Asnjë gisht i ngritur mbi filan apo fisteq politikan. Kjo pafuqi e qytetarit për t'i thënë "ndal!" keqtrajtimit të skajshëm të interesave të xhepit të tij rrit dëshirën për aventura dhe kuturisje të rrezikshme politike nga të dyja krahet. Fatura e protestave është e gjitha aty dhe ia vlen t'u lexohet përditë këtyre sabotuesve të së ardhmes së vendit, sa herë grinden si qentë për kocka në arenën e pushtetit

HOROSKOPI

DASHI

Do të favorizoheni në nisjen e një sipërmarrjeje të re. Mos humbni kohë, por përpuni të vini në zbatim projektet tuaja. Parashikimi për ditën e sotme sa i përket financave do të jetë pozitiv.

DEMI

Aftësia juaj për t'i pranuar gjërat që nuk mund të ndryshoni më jetën tuaj është për t'u pasur zili. Por sot, do të ishte gjëja e duhur nëse tregori, më shumë vullnet për risi. Në dashuri, yjet ju favorizojnë.

BINJAKET

Shfrytëzoni çdo gjë që është rreth jush për të arritur aty ku duhet të jeni, por mos u keqkuptoni. Kjo nuk ka të bëjë me shfrytëzimin e njerëzve ose lidhjeve që kenë. Ka të bëjë me mënyrën krijuese të përdorimit të burimeve që kenë në dispozicion.

GAFORJA

Thyerja e rregullave nuk është gjithmonë një gjë e keqe, veçanërisht nëse rregullat kufizojnë krijimtarinë ose suksesin tuaj. Njerëz të rinj do të hyjnë në jetën tuaj duke e bërë atë më emocionale.

LUANI

A jeni të lodhur nga prijet e gjata? Për t'i shpëtuar presioneve me të cilat përballeni ndiqni dëshirat tuaja. Ka ardhur koha që ju ta kapni demin nga birët dhe të thoni jo. Konfliktet nuk i do askush, por një moment në jetë ku ju duhet të ngjeshni në këmbë dhe të bëni rezistencë.

VIRGJERESHA

Sapo të zgjoheni këtë mëngjes, duhet të shkoni veten në pasqyrë dhe të reflektoni. Endrrat shqetësuese, pengesat e fundit dhe një ndjenjë e përgjithshme pesimizmi mund t'ju shkaktojë tension sot. Mundohuni të mos i merrni gjërat shumë seriozisht.

PESHORJA

Gjërat janë më të lehta nga sa i mendoni, veçanërisht në jetën tuaj romantike. Asgjë nuk është e pamundur, veçanërisht nëse kërkoni më shumë emocion. Kaloni në shumë kohë jashtë ambienteve të shtëpisë dhe njihni sa më shumë njerëz.

AKREPI

Nëse përballeni me një konflikt emocional sot, mos lejoni që të jeni ju agresori. Energia juaj është e përqendruar rreth kompromisit pozitiv tani, prandaj mbështetuni në më shumë metoda diplomatike në zgjidhjen e problemeve.

SHIGJETARI

Askush nuk mund t'ju japë falas ndonjë dozë besimi. Duhet që ta fitoni vetë atë. Ecnit përpara me kurajë edhe nëse ndjeni se nuk e keni mbështetjen e personave që keni pranë. Në dashuri, gjërat do të jenë të qëndrueshme.

BRICJAPI

Nëse dikush në jetën tuaj është i lëkundur për një vendim të rëndësishëm, sigurohuni që mos i shtyni planet dhe projektet tuaja. Një investim parashikohet të mos sjellë përfitime që do të dëshironit.

UJORI

Nëse gjendeni në vendin e duhur dhe në kohën e duhur mund të takoni njeriun e zemrës. Në punë, përpuni t'i merrni gjërat me qetësi duke shmangur stresin. Kështu do të keni edhe më shumë sukses.

PESHQIT

Mos e humbni kontaktin e drejtpërdrejtë me njerëzit. Ju keni nevojë që të jeni i rrethuar nga miq dhe të afërm. Në aspektin ekonomik, mund të merrni lajmë që do t'i prisni me pozitivitet. Në dashuri, jo gjithçka po ecën me ritëm e duhura.

MERRNI NE KOHE REALE LAJMET E FUNDIT NE APARATIN TUAJ

AGJENCIA E LAJMEVE MË E KLIKUAR NË HAPËSIRËN SHQIPTARE. LAJMET MË TË FUNDIT ME VIDEO DHE FOTO NGA VENDGJARJA, ANALIZA DHE TEMATIKA TË NDRYSHME, GJITHÇKA ME NJË KLIKIM.

INSTALONI APLIKACIONIN E BALKANWEB NE MOBILE DHE TABLET

KERKONI NE APPLE STORE DHE GOOGLE PLAY OSE DUKE SKANUAR QR CODE APPLE DHE ANDROID

MBROJTËSI I NAPOLIT



Bashkë me trajnerin Panuçi, në konferencë për shtyp ishte edhe mbrojtësi i Napolit, Elseid Hysaj, që sot do të luajë në stadiumin e qytetit të tij të lindjes, Shkodrës dhe si kapiten i ekipit Kombëtar, gjë që e bën tej mase krenar, ndërsa deklaroi se nuk është aspak i trembur nga Turqia.

Elseid Hysaj: Krenar që do të jem kapiten në Shkodër

"Sulmuesit që ka Turqia i kemi takuar edhe në Serinë A dhe aty kemi të bëjmë në çdo ndeshje me lojtarë të tillë dhe jemi përgatitur të mbrojmë mirë ndaj Turqisë. Edhe grupi që kemi tani është fantastik. Njihemi mirë me njëri-tjetrin. Kemi marrë leksione për gabimet që kemi bërë. Shpresoj të vazhdojmë nga ndeshja e fundit që e lamë me fitore. Jam i lumtur që do të luaj në shtëpinë time si

kapiten. Është ndjesi shumë e mirë. Nëse është nevoja të bëj edhe një rol tjetër, do ta bëj me gjithë maksimumin tim. Për Strakoshën nuk vendosim ne. Kush gabon, duhet të paguajë gabimin. I kam thënë të rrijë i qetë dhe të zërë mend për herët e tjera. Shpresoj ta kuptojë gabimin sa më shpejt".

Trajneri i Shqipërisë, në vigjilje të ndeshjes deklaroi se 90-minutëshi i sotëm është delikat, por ai është mjaft optimist



Jeton Selimi

Panuçi: Duam fitoren me Turqinë. Lenjani pa respekt, se grumbulloj më Italiani ka besim te lojtarët: Janë përgatitur mirë për ndeshjenn

Kristian Panuçi beson te sukcesi sot. Trajneri i Kombëtares së Shqipërisë në konferencën tradicionale në vigjilje të ndeshjes kundër Turqisë u shpreh se ekipi është stërvitur mirë dhe është gati për këtë përballje delikate ndaj një kundërshtari të fortë. Gjithashtu, ai u shpreh dhe për çështjen "Lenjani", ku theksoi se ka ndërmend t'ia plotësojë lojtarit dëshirën dhe nuk do ta grumbullojë më, duke e cilësuar përgjigjen e tij një mungesë respekti ndaj fanellës së ekipit Kombëtar.

Çfarë keni parë nga skuadra këto ditë?

Kanë punuar mirë. Është ambient mirë. Djemtë janë gati për ta luajtur këtë ndeshje. Të shikojmë nesër...

Në vitin 2018 Shqipëria shënoi vetëm 3 gola, si keni menduar ta përmirësoni këtë?

Ka ardhur Sadiku, edhe pse nuk është mirë. Kemi lojtarë që kanë bërë gola. Mjafton edhe 1 gol për të fituar ndeshjen. Kemi Sadikun, Balaj ka gjetur golin, kemi Grezden dhe Abazajn gjithashtu.

Duke qenë ndeshja e parë, është e rëndësishme ndaj një kundërshtari të fortë. Çfarë mesazhi u keni dhënë? Ku keni menduar ta godisni? Pika e tyre e fortë?



Është e vërtetë që kanë një skuadër të fortë, por nëse lojtarët kundërshtarë janë të përgendruar për 90 minuta, do të marrim një rezultat pozitiv. E dimë që është e vështirë, por shpresojmë.

Keni deklaruar më parë që do tentoni ta fitoni ndeshjen. Cilat janë pritshmëritë konkrete? Me çfarë rezultati do ishit i kënaqur?

Unë jam pozitiv dhe skuadra është e përgatitur. Ka kualitet, siç ka edhe Turqia. Jam i bindur që mund të arrijmë një fitore, por gjithçka mbetet për t'u parë nesër. Duhet të japim maksimumin në fushë.

Shumë lojtarë luajnë në skuadrat më të rëndësishme në Itali. Ku mendo

ni se ka potencial për të shkuar Shqipëria?

Skuadra ka potencial. Të përgendrohemi te Turqia dhe Islanda, Francën ta lëmë në terezinë e saj. Skuadra është e konsoliduar, por ka shumë rrugë për të bërë. Kjo skuadër është si një minë me sahat, mund të shpërthejë kurdo dhe të bëjë gjëra të mëdha.

Lenjani tha që "nuk vij më sa të jetë Panuçi". Mund të jetë si rasti "Khaka", që rikthehet? Sa e njihni Turqinë?

Lenjani është grumbulluar 6 herë, nga 9 grumbullime. Thirrja e fundit mungoi, sepse nuk ka luajtur. Lenjani nuk i ka shprehur mungesë respekti Panuçit apo Dukës, por Shqipërisë. Më vjen të qesh, të komentoj një lojtar që shkruan një letër në "Instagram", ajo që mund të bëjë është të pranohet kërkesën e tij.

Si ka ndryshuar futbolli turk? Një lojtar turk luan me Romën, ku keni qenë edhe ju, por nesër nuk do të jetë...

Futbolli turk si në të gjithë Europën ka rënë dhe ngritjet e veta. Gëzojmë që Under nuk do të jetë nesër, por ka lojtarë të tjerë shumë të mirë, të cilëve duhet t'ia kesh frikës. Ka edhe lojtarë patriotë dhe e shijojnë himnin kur këndohet në fillim të lojës.

MESFUSHORI KA PROBLEME

Sot mësohet shkalla e dëmtimit të Telushit, rrezikon 1 muaj

Bruno Telushi, mesfushori luftarak i Partizanit, vijon të jetë i shtruar në spital pas dëmtimit të rëndë që pësoi në sfidën ndaj Teutës. Vlonjati u godit në shpinë në një dyllufim ajror dhe pësoi një pneumotoraks, dëmtim të pleurës së mushkërisë, çka bën që ajri të kalojë në hapësirën e krahavorit. Telushi u dërgua me urgjencë në spital ku u intubua në mënyrë që ajri të dilte jashtë trupit, ndërsa sot është në ditën e tij të pestë në regjim spitalor. Nga sa mësohet nga burime pranë klubit të kuq, mesfushori rrezikon më shumë sesa ndeshjen me Kukësin, por gjithsesi diçka konkrete pritet të mësohet vetëm ditën e sotme sa i takon prognozës së dëmtimit. Bruno Telushi është një nga pikat thelbore të Partizanit të Skënder Gëgës. Vlonjati ka marrë çelësat e mesfushës së kuqe dhe po udhëheq ekipin duke u shndërruar në një nga liderët e heshur të skuadrës dhe mungesa e tij do të ndihet jo pak. Gjithsesi, tifozët shpresojnë në riaftësimin e tij të shpejtë, duke pasur besim dhe të shpirti luftarak i lojtarit, i cili është një nga ata që fjalën "dorëzim" nuk e ka në fjalor.

"Dardanët" janë në rrugën e duhur

Kosova, barazim spektakolar me Danimarkën

Kryesuar deri në minutën e 91-të, por të besuarit e Berнар Shaland u dorëzuan golit të Hojbjerg, që shpëtoi Danimarkën nga një humbje e merituar në "Fadil Vokrri" të Prishtinës. Në një stadium të tejmbushur, "Dardanët" kanë dhuruar spektakël, duke çuar në entuziazëm të pranishmit, që pas këtij rezultati kanë pritshmëri edhe më të mëdha për ekipin përfaqësues të Kosovës. Kosova do të kalojë në avantazh në fund të pjesës së parë, kur Armir Rrahmani do të çelë rezultatit në të 42'-ën. Ka qenë një harkim nga goditja e dënimit, që është shfrytëzuar në maksimum nga ish-lojtari i Partizanit dhe që me kokë ka mposhtur portierin Shmajkëll. Me fillimin e pjesës së dytë, Danimarka do të kërkojë barazimin dhe do ta gjejë me penalltinë e kthyer në gola nga Ereksin, por "Dardanët" nuk do të dorëzohen dhe vetëm 3 minuta më pas do të rikthejë në epërsi përfaqësuesen kosovare, e cila do të rrezikojë deri në kohën shtesë, për t'u thyer nga goli i Hojbjergut.

Mediat italiane janë të sigurta

Panuçi rrezikon shkarkimin, Shqipëria pak shanse



fundit "gjelat" kanë ditur të zgjedhin talentet e tyre. Finalistë në European, kampionë bote dhe një ekip i


mbushur me yje. Mbappe, Griezmann dhe Giroud formojnë një tredhëmbësh perfekt si në aspektin fizik ashtu edhe taktik, më pas në mesfushë kanë lojtarë si Pogba, Matuidi e Kante.

Surprizë - Islanda do të provojë edhe një herë të arrijë atë sukses të pabesueshëm në "Euro 2016". Një skuadër e fortë fizikisht, pa individë që mund të bëjnë diferencën në aspektin taktik. Shumë i ndryshëm dis-

kutimi për Turqinë. Pësoi rënie në Ligën e Kombeve duke zbritur në Kategorinë C. Një ekip që mund të arrijë fitore të mëdha në shtëpi, por transformohet në transfertë. Yjet janë Under, Calhanoglu e Tosun.

Të tjerat - Shqipëria e Panuçit ra përballë Skocisë dhe Izraelit, aq sa trajneri italian po rrezikon pankinën. Mund të shkarkohet nëse rezultatet vijojnë të jenë të këqinj. Sakaq, përjashtoi Strakoshën sepse humbi avionin. Moldavia dhe Andora mbyllën një grup që e ka tashmë një padron, Francën dhe me shumë gjasa edhe dy ekupe që do të diskutojnë për vendin e dytë e të tretë.

Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL

1. E famshja Curie
5. Më e mira është rekord.
9. Inicialet e Kurosawa-s.
11. Është edhe ai i mendimeve.
12. Një mund të jetë zemërkau
13. Është dollapi.
14. Gjysmë mimize.
15. Fillojnë sefte.
16. Ishte shkollë e Aristotelit.
20. Ndodh në kufij.
22. Bëhen me ambalazh.
23. Janë idhnakë.
25. Fillojnë tituj.
26. Do të bëhen pemë.
27. Ashtu si jeton heremitit.
29. Është dhomë e lartë.
30. Janë spanjollët dhe portugezët.
32. Ishte filozofi që preu damarët.

34. Janë gjuhë...veshi.
35. Musketierët e Dumas.
36. Lila këngëtare.
37. Kufizojnë takimet.
38. Ullmann aktore.
39. Mbledh baskët separatistë.
40. Fillojnë kapjen.
41. Inicialet e Delon.
43. Lumi i Bernës.
44. Është numri të parit.
45. Një thirrje me emra.

VERTIKAL

1. Farrow aktore.
2. Me Romeo në makinë.
3. Rolet pa zë.
4. Kufij itinerari.
5. Ai ekzekutiv u bë bashki.
6. Në mes të dhomës.
7. Një tabu islamike
8. Mbyllin fushatat.
10. Janë festime
11. Lehar kompozitor.
12. Janë shtyllat për vela
14. Ata të Ferrari-t qëndrojnë në box.
16. Duhet fituar me djersë.
17. Piktura pa kura.
18. Janë dokumente partie.
19. Në fund të vitit.
21. Farkëtoi armët e Akilit.
22. Një është për kërcim.
24. Athinaja e romakëve.
25. Janë kapriçiot.
27. Një tis mjegulle.
28. Kërcimi i Fred Astaire.
31. Edwards regjisor.
33. Parker regjisor.
38. Luan në kufij
39. Inicialet e Rohmer.
42. Fillojnë detyrën.


Fjalëkryqi (2)

HORIZONTAL


1. Lama i Tibetit.
5. Janë vendet e lira
11. Martin i Jack London.
13. Comaneci e famshme e gjimnastikës.
15. Ekstre me sirtar.
16. Janë princër arabë.
17. Një treshe në skenë.
19. Një provë inteligjence.
21. Gjysmë tatimi.
23. Gjysmë eolike.
24. Ekstre me studim.
25. Bëjnë stil të lirë
28. Ndal në kufij
29. Kaluar në krye.
30. Një tragjedi... e Dreiser.
33. Griet aktore.
34. Dashi kur mungon ai
36. Është zanore në filma
38. Kufizohet në kufij
39. Ente Civile Europiane.

VERTIKAL


40. Janë galeri në rrugë.
41. Ramazzotti këngëtar
42. Mbyllin një tender.
43. Agjenci Formacioni Tiranë.
44. Është pjesë e borxhit që paguhet.
46. Gjysmë kandi
48. Jessica Parker aktore.
49. Inicialet e Presley.
50. Nuk shuhej dot nga Tantalit.
51. Janë thënie e njerëzve të famshëm.
52. Qendër fitimi
1. Është halli.
2. Fillon me truga...
3. Kastile janë në fund
4. Janë në skaje
6. Është vendi aderues
7. Ka kryeqytet Doha.
8. Inicialet e Daudet.
9. Ndërmarrje Industriale Tiranë.
10. Iglit te Lazio.
12. Janë zjarrvënës.
14. Flanders e Defoe.
18. Shkroi Rinoceronti.
20. Ekstre me slam.
22. Janë trille.
25. Qytet italian.
26. Jepen për hartim.
27. Fillojë takimet.
29. Kufizojnë kënde.
31. Janë vendet e para.
32. Një greminë.
35. Është logjarin që qërohet.
36. Ndiqen me ilaçe.
37. Massari aktore italiane.
38. Është melodramë.
40. Një thirrje e dëshiruar nga maja e direktur.
41. Kush ka... fërgëllon.
44. Një i fundit mbi të gjithë.
45. Një pjesë e satelitëve.
47. Në krye të njerëzve.
48. Sikur janë në krye.
49. Inicialet e Taylor që qe aktore..



Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

PËRGJIGJET E FJALËKRYQEVE TË NUMRIT TË KALUAR

A	V	A	T	I	S	A	L	A	M	I	N	A
L	A	N	A	F	E	A	R	I	S			
A	L	N	E	N	A	P	T	O	P			
I	E	G	E	R	S	I	R	A	T	B	I	
I	A	S	M	O	D	E	U	M	I	R		
S	A	M	T	A	R	A	F	E				
M	R	O	N	I	N	O	M	A	R	A	E	T
H	A	B	E	R	I	O	M	A	R	A	E	T
R	I	T	S	E	R	I	T	E				
T	E	M	E	B	E	L	T	E	V			
O	T	M	E	R	I	T	A	S	A	M		
N	A	R	I	A	N	A	A	R	M	A	N	I
M	A	R	N	I	E	P	R	M	I	T	E	S
I	N	A	I	U	M	A	D	I	E	S		
S	T	U	S	E	N	D	E	R	E	A		
T	E	L	T	U	N	D	I	M	I	A	U	
E	N	K	E	N	D	I	M	I	S			
R	A	A	F	J	O	E	B	E	L	E	S	
T	I	A	A	A	N	A	K	I				
O	K	A	N	A	I	S	A	R	N	A		
Z	E	L	L	I	L	I	M	E	D	A		
E	T	B	A	R	I	T	O	N	T	O	R	A
T	O	K	A	A	L	L	E	R	A			
M	I	N	I	M	A	L	E	S	T	E	R	

FJALËKRYQI (1)

FJALËKRYQI (2)

SUDOK

			1		2			
			9				7	
4		7	8					1
6		9	8					
		7						5
				2	4			
5								
1		9	8				7	
			3		4		9	

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

3	1	5	9	2	6	7	4	8
4	6	2	7	8	1	9	5	3
9	7	8	3	5	4	1	6	2
2	5	6	4	1	3	8	9	7
7	4	9	2	6	8	3	1	5
1	8	3	5	9	7	4	2	6
5	2	7	1	3	9	6	8	4
6	9	4	8	7	5	2	3	1
8	3	1	6	4	2	5	7	9

Argëtim filozofik

- Kam filluar dietë. Ndaloja dhe pijen, dhe në dy javë kam humbur 14 ditë.
- Asnjëherë mos e shty për nesër atë që ju mund të bëni pasnesër.
- Ndërsa përpiqemi për t'u mësuar fëmijëve tanë gjithcka për jetën, fëmijët tanë na mësojnë se çfarë është jeta.
- Unë e dua njerëzimin. Njerëzit nuk mund ti duroj.
- Nëse jeni duke kërkuar për një mik, do të zbuloni se është e vështirë për të gjetur. Nëse je i gatshëm të jesh mik, do t'i gjeni ata kudo.

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME
Përgjigja e numrit të djeshëm

4	6		8	3	6	10		10	4	16	3	2	
10	3	9	5	7	4		8		6	12	4		
4	4		19	4	11	1	2	3	18	5	2		
18		11	5	6	5	13	5	9	4	7	3	2	
5	12	3	2	5	6	3	2		9	5		5	
		6	4	2	4		17		4	1	5		
5	2	3		3	7		2	5		4	6	1	
13	3	12	3	2	3		4	2	5	13	5		
2	13	16			2	3	E	5	12		2	5	
17	12	4	1	12		7	M	6		2		13	
5	4		7	4	8	4	I	1	12	5	6	4	2
9	13	8			2	17	R	4	9	2	3	2	

T	E	K		B	O	M		B	R	E	D	H
O	R	A	T	O	R	E	T		E	S	E	
G	N	O	T	A	R	E	T		T	M	T	
E	A	M	E	R	I	K	A	N	E	T		
R	S	L		R	E	T	E		E	R	I	K
		P	E	L	O	T	A		D	V	M	A
S	O	T		R	T	A	R	E	E	T		
T	R			G		P	A	R	E	E	T	E
E	T	L		A	R	I	T	M	I	A		
F	I	L	I	Z	A	T	E	A		G	A	
A				D	I	T	E	T		T	O	M
N	O	B	I	L	E		B	A	N	A	L	E

Thënie të mençura

- Shmëntia është superior ndaj bukurisë, sepse ajo zgjat më shumë.
- Martesa është mrekullia që transformon puthjen nga kënaqësi në detyrë.
- Të qeshësh me gabimet e tua, të zgjat jetën. Për të qeshësh me gabimet e të tjerëve, mund të ta zvogëltojë.
- Fjala "nesër" u krijua për njerëzit e pavendosur dhe për fëmijët.
- Një fëmijë hyn në shtëpinë tuaj dhe bën aq zhurmë për njëzet vjet, e cila është e vështirë të durohet.
- Pastaj, largohet duke e lënë shtëpinë aq të heshtur sa që mendoni se do të çmendeni.

